



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.30

31 mars

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.142, datë 23.2.2011

Për miratimin e “Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore” dhe të dokumentit plotësues “Plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit”. 1051

Vendim i GJK
nr.8, datë 16.3.2011

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.212, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.110, datë 9.10.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë, nr.00-2009-152 (447), datë 25.9.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) si të papajtueshme me Kushtetutën..... 1083

VENDIM
Nr.142, datë 23.2.2011

PËR MIRATIMIN E “PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE” DHE TË DOKUMENTIT PLOTËSUES “PLANI I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore” dhe të dokumentit plotësues “Plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit”, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministrinë, si dhe institucionet e tjera qendrore e vendore, të përmendura në tekstin e këtyre planeve të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për monitorimin e zbatimit të këtyre planeve të veprimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT

PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

I. NDJEKJA DHE DREJTËSIA PENALE

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Rritja e numrit të ndjekjeve penale të suksesshme, si dhe masave të duhura të dënimit për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, si brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet strukturave efikase dhe profesionale të zbatimit të ligjit që kryejnë hetime proaktive dhe procese gjyqësore që garantojnë të drejtat e të gjitha palëve.				
	Treguesit: numri i ndjekjeve penale dhe masa e dënimeve sipas formës së trafikimit dhe llojit të shfrytëzimit, përfshirë edhe shfrytëzimin për punë dhe lypje, vendit të shfrytëzimit (i brendshëm dhe i ndërkufitar), numri i viktimave që dalin dëshmitarë, numri i proceseve gjyqësore që i mbështesin viktimat me prova të vërtetuara				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër trafikimit të njerëzve, duke u fokusuar edhe në identifikimin proaktiv të viktimave të trafikimit të shfrytëzuara si brenda dhe jashtë vendit				
	Treguesit: Numri i ndjekjeve penale kundër trafikimit nisur nga provat e siguruar nëpërmjet hetimesh proaktive; numri i dënimeve të mbështetura mbi prova proaktive				
1.(a).1	Përdorimi me efikasitet i një sistemi menaxhimi të informacioneve të fshehta mbi trafikimin e qenieve njerëzore (mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacioneve të fshehta), në përputhje me planin informativ kombëtar dhe në zbatim të urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.69, datë 25.1.2010	Policia e Shtetit, SHISH, Avokati i Popullit të mbështetur nga ICITAP, PAMECA	Në vazhdimësi	Përgatitja e raporteve tremujore të informacioneve të fshehta, analizave të situatës, përcaktimi i profilit të trafikantëve/viktimave Bërja e një analize të hollësishme mbi informacionet e marra në bazë mujore Grumbullimi dhe analizimi i informacionit nëpërmjet përdorimit të sistemit MEMEX	Ekzistuese
1.(a).2	Rritja e njohurive dhe aftësive të nëpunësve të zbatimit të ligjit për teknikat proaktive të hetimit me qëllim evidentimin e rasteve të reja të trafikimit në mënyrë të veçantë ato të trafikimit të brendshëm me qëllim shfrytëzimi për punë, lypje etj.	Akademia e Policisë, Departamenti i Trajnimeve në PSH, Prokuroria, Shkolla e Magjistraturës me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, si: IOM, OSBE, ICMPD, UNICEF, UNODC etj.	Në vazhdimësi	Numri i oficerëve të specializuar të zbatimit të ligjit, të trajnuar për aplikimin e teknikave të hetimit të orientuara nga informacionet kriminale; nr. i punonjësve të zbatimit të ligjit të vijës së parë, të cilëve u është siguruar trajnimi bazë mbi mbledhjen e nivelit të ulët të informacioneve kriminale. Personeli i Policisë në Sektorin kundër Trafiqeve të Paligjshme në secilën drejtori rajonale të jetë i njohur me metodën proaktive të hetimit dhe metodën e policimit të orientuar nga informacionet kriminale përfshirë edhe shfrytëzimin e personave për punë.	Ekzistuese
1.(a).3	Rritja e numrit të hetimeve për pastrimin e produkteve të veprës penale që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore.	Ministria e Financave/Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave, PP, Policia e Shtetit/Drejtoria kundër Krimit Ekonomik, Doganat	Në vazhdimësi	Numri i procedimeve penale për pastrimin e parave. Asetet e sekuestruara dhe vlera e tyre	Ekzistuese
1.(a).3.1.	Rritja e numrit të hetimeve pasurore për personat me veprimtari në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore. Fuqizimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të strukturave të hetimit të pastrimit të parave dhe hetimit të aseteve kriminale.	Ministria e Financave në bashkëpunim me Prokurorinë, Policinë e Shtetit/Drejtorinë kundër Krimit Ekonomik	Në vazhdimësi	Numri i hetimeve pasurore sipas ligjit antimafia. Asetet e sekuestruara dhe vlera e tyre Numri i trajnimeve dhe përfituesit.	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
1.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, si në nivel të përgjithshëm, ashtu edhe në atë të specializuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore				
	Treguesit: numri i personelit të policisë (meshkuj/femra) të punësuar me kohë të plotë dhe të kualifikuar kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel qendror dhe rajonal, qarkullimi/mbajtja e personelit të antitrafikimit, numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve të krimeve të rënda të trajnuar në fushën e antitrafikimit; numri i çështjeve që rezultojnë në procedime penale dhe dënime; numri i zyrtarëve në polici, prokurori dhe gjyqësor, që mund të përshkruajnë karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore				
1.(b).1	Sigurimi i profesionalizmit dhe kapacitetit të Sektorit kundër Trafiqeve të Paligjshme në Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Rajonale të Policisë nëpërmjet personelit të mjaftueshëm dhe të kualifikuar/trajnuar, si dhe një numri më të madh të oficerëve femra të kualifikuara të policisë.	Policia e Shtetit e ndihmuar nga ZKKA Akademia e Policisë dhe Sektori kundër Trafiqeve të Paligjshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët ndërkombëtarë (OSBE, UNICEF, IOM, ICMPD etj.)	Në vazhdimësi	Të paktën një oficerë policie femër e trajnuar është caktuar në çdo sektor antitrafik në nivel qarku; Trajnimi ose ritrajnimi sipas nevojës i gjithë personelit të antitrafikimit	Ekzistuese
1.(b).1.1	Sigurimi i pajisjeve të nevojshme për seksionet antitrafik të policisë	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Qershor 2011	Pajisjet e nevojshme janë të disponueshme	Ekzistuese
1.(b).1.2	Ngritja e kapaciteteve të seksioneve të mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje në Policinë e Shtetit, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me aktorë të tjerë, me qëllim evidentimin, koordinimin dhe referimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve pranë strukturave policore kundër trafiqeve të paligjshme	Akademia e Policisë, Seksioni i Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje dhe Sektori kundër Trafiqeve të Paligjshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët ndërkombëtarë (OSBE, UNICEF, IOM, UNIFEM, UNDP, UNODC etj.)	Deri në fund të vitit 2011	Seksionet e mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje të kenë trajnimin e duhur për të evidentuar dhe referuar rastet e trafikimit të të miturve pranë strukturave policore përgjegjëse të specializuara	Ekzistuese
1.(b).1.3	Sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë, bashkërendimi sistematik dhe ndarjeje informacioni midis sektorëve kundër trafiqeve të paligjshme dhe seksioneve për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Protokollet e mbledhjeve sistematike që zhvillohen Numri i çështjeve të filluara nëpërmjet bashkëpunimit me Seksionin e Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje	Ekzistuese
1.(b).1.4	Rishikimi i politikave të rekrutimit të oficerëve të policisë të angazhuar në luftën kundër trafikimit në njerëz, për të siguruar qëndrueshmërinë e personelit të specializuar të policisë për të paktën tre vjet.	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Nxjerrja e urdhrat; Të dhënat e personelit tregojnë një mesatare periudhë punësimi prej të paktën tre vjetësh të stafit të sektorëve kundër trafiqeve të paligjshme në qendër dhe në bazë.	Ekzistuese
1.(b).2	Institucionalizimi i plotë i trajnimeve të detyrueshme mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore të orientuar te viktimat, si edhe ngritjen e kapaciteteve të të gjithë oficerëve të policisë, prokurorisë dhe gjykatës, të organizuara nga grupe multidisiplinare që përfshijnë dhe OJF:	Akademia e Policisë, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, ZKKA, OJF, KKSAT, me mbështetjen e OSBE, UNICEF, IOM, ICMPD dhe partnerë të tjerë	Në vazhdimësi	Kurrikula e përditësuar për trafikimin e qenieve njerëzore në Akademinë e Policisë dhe Shkollën e Magjistraturës e institucionalizuar (e përfshirë në programin bazë); Hartimi i listës së trajnerëve dhe trajnimit të tyre I gjithë personeli antitrafik prokurorët gjyqtarët e krimeve të rënda janë të trajnuar	Ekzistuese
1.(b).2.1	Trajnim për njohuritë bazë, përfshi identifikimin fillestar të viktimës dhe mbledhjen e informacioneve kriminale të nivelit të ulët, për të gjithë kadetët e rinj të policisë, si edhe oficerët aktivë të policisë (trajnim në detyrë)	Akademia e Policisë, Policia e Shtetit/Sektori kundër Trafiqeve të Paligjshme, PP, ZKKA, ON, OJF etj.	Në vazhdimësi	Materiale standarde trajnimit të vlefshme dhe të përditësuara çdo vit Ekzistenca e vlerësimeve vjetore të nevojave për trajnim dhe e planeve përkatëse të trajnimit	Ekzistuese
1.(b).2.2	Trajnim për njohuritë bazë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm	Shkolla e Magjistraturës, me partneret përkatës (ON dhe OJF),	Në vazhdimësi	Materiale standarde trajnimit të vlefshme dhe të përditësuara çdo vit	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
		ZKKA etj.		Ekzistenca e vlerësimeve vjetore të nevojave për trajnim dhe e planeve përkatëse të trajnimit	
1.(b).2.3	Seminar me objekt trajtimin e disa çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e procesit gjyqësor, si: Marrja e provës në fazën e hetimit paraprak; Marrja e dëshmisë së të dëmtuarve nëpërmjet sigurimit të provës; Detyrimi ose jo i të dëmtuarve për të dëshmuar në rastet e bashkëjetesës ose martesës me tutorët e tyre; Konceptet e bashkëpunimit në veprën penale të trafikimit të femrave me qëllim shfrytëzimi për prostitucion; Vlera e vendimit penal të huaj dhe parimi “ne bis in idem”.	Shkolla e Magjistraturës, Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit për Krimet e Rënda; Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, MD me mbështetjen e partnerëve (ON dhe OJF), ZKKA etj.	6-mujori i parë 2012	Përgatitja e materialeve për zhvillimin e seminarit. Zhvillimi i seminarit Synimi: Përgatitja e një analize të praktikës ligjore për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale, që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore. Unifikimi i qëndrimeve për të gjitha konceptet dhe elementet gjatë gjykimin të çështjes.	Ekzistuese
1.(b).2.4	Trajnim (i përbashkët) i specializuar për policinë, prokurorinë dhe gjykatat për përgjegjësitë respektive në drejtim të antitrafikimit përfshirë edhe trajnime me tematika të veçanta për shfrytëzimin e personave për punë (personeli i policisë antitrafik, prokurorët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Krimeve të Rënda)	Akademia e Policisë, Policia e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës PP-ja, MD, ZKKA, ON, OJF etj.	Viti akademik 2011-2012 2012-2013	Materiale standarde trajnimi të vlefshme dhe të përditësuara çdo vit Ekzistenca e vlerësimeve vjetore të nevojave për trajnim dhe e planeve përkatëse të trajnimit	Ekzistuese
1.(c)	OBJEKTIV SPECIFIK: Përmirësimi i hetimit të rasteve të trafikimit, duke rritur bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet policisë dhe prokurorisë, përfshirë edhe institucionet e tjera, të cilat disponojnë informacione të vlefshme për evidentimin e rasteve të reja të trafikimit në njerëz				
	Synimi: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në hetimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në veçanti midis policisë dhe prokurorisë, duke respektuar rolet dhe përgjegjësitë në zbatim ligjeve dhe akteve nënligjore				
	Treguesit: Numri dhe cilësia e hetimeve; Numri dhe masa e dënimeve kundrejt numrit të procedimeve penale; numri i informacioneve të referuara nga institucione dhe aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshetërorë, numri i zyrtarëve të njohur me procesin e ri hetimor kundër trafikimit				
1.(c).1	Krijimi dhe zbatimi i procedurave standarde operative për të gjithë procesin hetimor antitrafik	Grupi i punës kryesuar nga PP, Policia e Shtetit me mbështetjen e ON, BKTF-së dhe OJF-ve të tjera.	Në vazhdimësi	Hartimi dhe vënia në zbatim e procedurave standarde operative Krijimi dhe vënia në zbatim e modelit dhe e standarteve të cilësisë për dosjen hetimore Zbatimi i urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1101, datë 29.9.2009 “Për miratimin e procedurave standarde të punës për hetimin e krimeve”	Ekzistuese
1.(c).2	Seanca të përbashkëta trajnimi të policisë antitrafik dhe të prokurorisë (si pjesë e planit të trajnimit)	Akademia e Policisë, Shkolla e Magjistraturës, ZKKA, PP në bashkëpunim me ON dhe OJF.	Në vazhdimësi	Numri i personelit antitrafik që janë trajnuar dhe i prokurorëve të specializuar Seancë periodike trajnimi, parashikuar në planet kombëtare të trajnimit	Ekzistuese
1.(c).3	Hartimi i paketës/udhëzuesit hetimor antitrafikim dhe shpërndarja e tij në të gjitha seksionet e posaçme antitrafikim dhe në prokurori. Përgatitja e përditësimeve sistematike (në bazë vjetore)	Akademia e Policisë me Policinë Antitrafik, PP dhe ZKKA	2011	Vënia në dispozicion e paketës antitrafikim Kopje referimi në çdo seksion rajonal antitrafikim dhe në prokurori Paketa e përditësuar në dispozicion	Ekzistuese
1. (d)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Hartimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i bazës ligjore e rregullatore kundër të gjitha formave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimeve të lidhura me të, në përputhje me konventat e OKB-së, standardet dhe praktikatat e BE-së dhe Këshillit të Europës				
	Tregues: numri i oficerëve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, që kanë njohuri për dallimin ndërmjet trafikimit, kontrabandimit, shfrytëzimit për punë, dhe mund t'i shpjegojnë këto; numri i procedimeve penale të rasteve të trafikimit për punë të detyruar;				
1(d).1	Përgatitja e një studimi të plotë mbi kuadrin ligjor rregullator të fushës së luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore	MD, PP, gjykatat, MB-PSH, në bashkëpunim me ON, OJF.	6-mujori i parë i vitit 2011	Identifikimi i hapësirave dhe mangësive ligjore në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
				Rritja e përfshirjes së sindikatave për të raportuar raste të shfrytëzimit për punë.	
1(d)1.1.	Në bazë të rezultateve të studimit të lartpërmendur, ndërmarrja e iniciativave ligjore për luftën kundër trafikimit të njerëzve ose përmirësimin e akteve nënligjore apo neneve specifike të kuadrit ligjor antitrafik.	MD, PP, gjykatat, MB - PSH në bashkëpunim me ON, OJF.	6-mujori i dytë i vitit 2011	Përmirësimi i kuadrit të brendshëm ligjor në përputhje me atë ndërkombëtar Lehtësimi i viktimës nga taksat e aplikuarat gjatë zhvillimit të procesit penal dhe civil Të gjitha strukturat e specializuara gjatë gjithë procesit kanë në qendër të vëmendjes viktimën e trafikimit dhe sigurimin ndaj saj/tij të një mbrojtje sa më të përshtatshme	Ekzistuese
1.(d).1.2	Sigurimi i zbatimit të Konventës së Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore	Ministria e Drejtësisë, ZKKA, në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe të tjerë	Në vazhdimësi	Organizmi i një fushate ndërgjegjësimi për njohjen dhe zbatimin e Konventës me të gjithë institucionet përgjegjëse përfshirë edhe gjyqësorin Ekzistenca e një plani konkret veprimi me aktivitetet specifike, të cilat të mundësojnë monitorimin e zbatimit të Konventës.	Ekzistuese
1.(e)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi i bashkëpunimit midis policisë, prokurorisë, gjykatave dhe institucioneve të drejtësisë penale për krijimin e një sistemi të unifikuar informacioni, menaxhimi të dhënash dhe raportimi për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore				
	Synime: Krijimi i një sistemi të përbashkët, të unifikuar të dhënash midis policisë, prokurorisë dhe gjykatave për shkëmbimin, hartimin dhe analizën e të dhënave për të gjitha çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore; Pasurimi me rubrika të reja dhe përgatitja e të dhënave statistikore vetëm për TQNJ për të gjitha shkallët e gjyqimit, si dhe sigurimi i shkëmbimit të këtyre të dhënave në mënyrë të ndërsjellë nga strukturat e zbatimit të ligjit (PSH-PP-GJYKATA). Statistika ndërstrukturore për ndjekjet penale, dënimet, gjykimet dhe vendimet e marra për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, përfshi të dhënat mbi numrin, gjininë, moshën, kombësinë dhe statusin e viktimës				
	Treguesit: Ekzistenca e raporteve të përbashkëta ndërinstytucionale statistikore e vlerësuese, përfshi numrin e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve, si dhe të dhëna të plota si për viktimën ashtu edhe për autorët e veprës penale (trafikantët).				
1.(e).1	Krijimi i një sistemi të unifikuar të administrimit të të dhënave ndërmjet policisë, prokurorisë dhe institucioneve të drejtësisë penale (mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave të unifikuara statistikore mes të gjithë aktorëve, bazuar në përkufizimet e pranuar, përfshi hetimin, ndjekjet penale, dënimet, gjykimet dhe vendimet e marra për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, si edhe analizimi dhe zgjidhja e problemeve që lindin).	Ministria e Drejtësisë, PP, Policia e Shtetit, ZKKA, shoqëria civile	6-mujori i dytë i vitit 2011 dhe në vazhdim	Vënia në funksionim e bazës të dhënave me të dhëna statistikore ndërmjet strukturave përkatëse Arritja e marrëveshjes për përkufizimet e përbashkëta, përfshi arrestimet, ndjekjet penale, dënimet dhe vendimet e qëndrueshme; Arritja e marrëveshjes mbi matricën e përbashkët statistikore, metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe procedurat e raportimit; Hartimi i raportit të parë të përbashkët tremujor, me qëllim analizimin dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin në vazhdimësi.	Ekzistuese
1.(e).2	Thelimi i operativitetit të Sistemit Total të Administrimit të Informacionit (TIMS) dhe sistemit MEMEX	Policia e Shtetit me mbështetjen e BE-së, ICITAP-it dhe të partnerëve të tjerë	Në vazhdimësi	Pasqyrimi në sistemin TIMS dhe MEMEX i të dhënave lidhur me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore (të dhëna për viktimat dhe për autorët/trafikantët).	Ekzistuese
1.(f)	OBJEKTIV SPECIFIK: Përmirësimi në vazhdim i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e drejtësisë penale, gjyqësorit dhe në fushën e zbatimit të ligjit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore				
	Treguesit: Nr. i ekstradimeve; nr. i kërkesave për ndihmë ligjore të ndërsjellë, nr. i protokolleve të reja mbi bashkëpunimin policor, nr. i operacioneve të përbashkëta dhe procedimeve penale, si rezultat i bashkëpunimit ndërkufitar ose ndërkombëtar				
1.(f).1	Nënshkrimi i protokolleve në zbatim të Konventës së Këshillit të Europës mbi ndihmën e ndërsjellë ligjore,	Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me MPJ dhe MB	2011-2013	Kryerja e vlerësimit të nevojave, për të identifikuar vendet dhe tipin e kimit që	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	njohjen e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe ekstradimet e monitorimin e zbatimit të tyre.			ka përparësi, ku nevojitet përmirësimi i rrjetit të drejtësisë penale ndërkombëtare/rajonale. Nënshkrimi i protokolleve përkatëse	
1.(f).2	Forcimi i bashkëpunimit dypalësh dhe ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore përfshirë edhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit	Policia e Shtetit/MB, MD, MPJ me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Numri i takimeve të rregullta dhe ushtrimeve të përbashkëta që janë kryer Synimi: të paktën një veprimtari e përbashkët/ vizitë ndërlidhëse e organizuar mbi bazë vjetore me secilin vend fqinj dhe vende të tjera kyçe destinacioni	Ekzistuese
1.(f).2.1	Përfundimi dhe/ose zbatimi i marrëveshjeve/protokolleve për shkëmbimin e të dhënave dhe për kryerjen e hetimeve të përbashkëta me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë, si edhe me vendet e tjera të BE-së sipas nevojës	Policia e Shtetit/MB, MPJ	2011-2012	Nënshkrimi i marrëveshjeve/protokolleve me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë, si edhe me vendet e tjera të BE-së Përfundimi i marrëveshjeve për krijimin e skuadrave të përbashkëta të hetimit dhe survejimit ndërkufitar me vendet e rajonit, të cilat janë pjesë e Konventës së Vjenës.	Ekzistuese
1.(f).2.2	Vazhdimi i pjesëmarrjes në veprimtaritë rajonale/ndërkombëtare kundër trafikimit, organizuar nga Qendra SECI, si dhe Interpoli	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Numri dhe shpeshtësia e operacioneve të përbashkëta hetimore	Ekzistuese
1.(f).3	Vazhdimi i manovrave të përbashkëta detare me fqinjët bregdetarë (Italinë dhe Greqinë).	Ministria e Mbrojtjes, Policia e Shtetit/MB	Në vazhdimësi	Numri i manovrave të përbashkëta detare të kryera me fqinjët bregdetarë Numri i ndalimeve, numri i viktimave të identifikuar	
1.(g)	OBJEKTIV SPECIFIK: Sigurimi i një trajtimi të përshtatshëm dhe jodiskriminues i personave të trafikuar nga zbatuesit e ligjit dhe gjyqësori dhe informimi i viktimave për të drejtat e tyre dhe krijimi i mundësisë për t'i ushtruar këto të drejta				
Treguesit: Numri i personave të trafikuar që denoncojnë një trajtim diskriminues;					
1.(g).1	Sigurimi i një trajtimi të përshtatshëm, të ndjeshëm dhe të orientuar në të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit nga zbatuesit e ligjit dhe sistemi i drejtësisë. [Për më tepër shiko Shtyllën Mbrojtja]	Policia e Shtetit, PP, MPCSSHB, MD, Shkolla e Magjistraturës,	Në vazhdimësi	Numri i zyrtarëve që kanë kontaktuar me personat e trafikuar dhe që kanë njohuri të thelluara për të drejtat e tyre.	Ekzistuese
1.(g).1.1	Zbatimi i udhëzimeve të intervistimit të ndjeshme ndaj viktimës dhe i teknikave të përshtatshme të intervistimit.	Policia e Shtetit/Akademia e Policisë, MPCSSHB, PP, së bashku me grupin e punës të MKR-së, KKSAT, me mbështetjen e ZKKA, ON dhe OJF-ve	Në vazhdimësi	Udhëzimet e shpërndara dhe aktorët përkatës të trajnuar Numri i zyrtarëve përkatës që janë në dijeni të udhëzimeve dhe mund të përshkruajnë qasjen e ndjeshme ndaj viktimës	Ekzistuese
1.(g).1.2	Trajnimi i zyrtarëve kryesorë (Gjykata për Krimet e Rënda, gjykatësit aktualë, policia antitrafik.) mbi trajtimin e ndjeshëm të viktimës dhe të drejtën e viktimës për informim	Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Policisë në bashkëpunim me OSBE, ICMPD, UNODC dhe partnerët e tjerë	Në vazhdimësi	Numri i personave që kanë përfunduar trajnimin në mënyrë të suksesshme	Ekzistuese
1.(g).2	Të sigurohet që viktimat janë të informuara mbi të drejtat e tyre, mbi rreziqet dhe përfitimet e mundshme të procedimeve penale, dhe të sigurohet zbatimi i së drejtës ligjore të viktimës për t'u informuar mbi të drejtat e veta, për të marrë këshillim e përfaqësim ligjor falas.	MD – Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, PP, Policia e Shtetit, OJF	Në vazhdimësi	Ekzistenca e materialeve informuese Numri i personave të trafikuar që kanë marrë material informues Numri i personave të trafikuar që kanë marrë këshillim ligjor	Ekzistuese
1.(g).2.1	Sigurimi i këshillimit dhe përfaqësimit të gjithë personave të	PP, Dhoma Kombëtare e	Në vazhdimësi	Këshillimi dhe përfaqësimi ligjor mbështetjet me buxhet	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	trafikuar nga grupimet ekzistuese të avokatëve ose nëpërmjet marrëveshjeve me klinikat ligjore etj.	Avokatisë, Komisioni Shtetëror i Ndhmës juridike, MD, njësitë e asistencës dhe mbrojtjes sociale, Policia e Shtetit, OJF të specializuara në ofrimin e ndihmës juridike		dhe është në dispozicion të viktimave Krijimi i praktikave dhe rritja e ekspertizës për këshillimin dhe përfaqësimin ligjor të viktimave të trafikimit	
1.(h)	OBJEKTIV SPECIFIK: Sigurimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit ligjor për viktimën e trafikimit				
	Tregues: Ekzistenca e fondit për kompensimin e viktimave; numri i personave të trafikuar që kanë përfituar kompensim dhe masa e përfitimit e shprehur në vlerë monetare; numri i personave të trafikuar, të cilët janë të informuar mbi mundësitë e kompensimit; numri i ankesave të paraqitura në Gjykatë për çështjet e kompensimit; numri i çështjeve të fituara nga viktimat me objekt kompensimin përfshirë edhe rastet e trafikimit me qëllim shfrytëzimi për punë.				
1.(h).1.	Zbatimi i ligjit nr.10 192, datë 11.11.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe akteve nënligjore. Përcaktimi i pasurive të konfiskuara në funksion të kompensimit të personave të trafikuar, duke përfshirë edhe krijimin dhe funksionimin e fondit të posaçëm për parandalimin e krimit dhe formimin ligjor.	MD, MF, MB, Policia e Shtetit, ZKKA dhe partnerë të tjerë	Në vazhdimësi	Mbledhja e rregullt e Komitetit Këshillues për Masat kundër Krimit të Organizuar. Numri i mbledhjeve të zhvilluara. Krijimi i fondit të posaçëm Numri i vendimeve të Komitetit Këshillues mbi përdorimin e pasurive të konfiskuara për kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit	Ekzistuese
1.(h).2	Rritja e efektivitetit të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)	AAPSK, MF, PP, Policia e Shtetit	2011	Ekzistenca e procedurave standarde operative Numri i pasurive të konfiskuara dhe sasia e tyre në lekë	Ekzistuese
1.(h).3	Krijimi i një skeme shtetërore kompensimi për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke përdorur si pasuritë e konfiskuara, ashtu edhe financimin nga qeveria nëpërmjet nxjerrjes së një akti mbi administrimin e fondeve që burojnë nga pasuritë kriminale të konfiskuara	MF, Policia e Shtetit, MPÇSSHB në bashkëpunim me PP/PKR, MD, ZKKA dhe me asistencën e, UN, partnerë të tjerë, ON dhe OJF	2011	Ekzistenca e skemës shtetërore të kompensimit Numri i personave të trafikuar që kanë marrë kompensim	Ekzistuese
1.(h).3.1	Përcaktimi i përqindjes së saktë të të ardhurave nga fondi i posaçëm për të siguruar kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit	Këshilli i Ministrave, MF, ZKKA, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë	2011 dhe në vazhdimësi	Përqindja e pasurive të konfiskuara të kaluara në fondin e posaçëm	Ekzistuese
1.(h).3.2	Krijimi i procedurave për aksesin në skemë dhe bërja e tyre publike	MF, AAPSK, ZKKA, PAMECA në partneritet me OSBE	Fundi i 2011	Vënia në zbatim dhe publikimi i procedurave për hyrjen në skemë	Ekzistuese
1.(h).4.	Sigurimi i informacionit paraprak për të gjithë personat e trafikuar në lidhje me të drejtën e tyre për kompensim dhe mënyrën si të përfitojnë nga fondi i kompensimit dhe ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimit ligjor falas, për t'i ndihmuar viktimat të marrin kompensim nëpërmjet skemës shtetërore	PP, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë	Në vazhdimësi	Numri dhe përqindja e viktimave që kanë marrë materiale informuese dhe këshillim për mundësitë e kompensimit Numri i viktimave që kanë marrë ndihmë dhe përfaqësim ligjor	Ekzistuese
1.(i)	OBJEKTIV SPECIFIK: Forcimi i luftës kundër korrupsionit në radhët e zyrtarëve të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore				
	Tregues: numri i sanksioneve disiplinore/administrative dhe i ndjekjeve penale/dënimeve të oficerëve të policisë, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në trafikim; numri i informacioneve të fshehta mbi bashkëpunimin e zyrtarëve për mundësimin e trafikimit të qenieve njerëzore, numri i çështjeve të hapura mbi bazën e informacioneve të fshehta të marra nga publiku; masat ligjore (urdhra, udhëzime dhe akte të tjera) dhe institucionale (numri i personave të përfshirë në strukturat monitoruese dhe hetuese).				
1.(i).1	Sigurimi i ndjekjes penale dhe dënimi i të gjithë oficerëve të policisë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë publikë, të cilët janë pjesëmarrës ose ndërmjetësojnë në trafikimin e qenieve njerëzore	Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm / MB, MD-ja në bashkëpunim me PP-në	Në vazhdimësi	Numri i oficerëve të policisë, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë publikë në ndjekje penale dhe të dënuar	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
1.(i).2	Forcimi i Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, duke synuar përmirësimin e hetimit të punonjësve të policisë të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore	MB, SHISH, PP	Në vazhdimësi	Numri i rasteve të suksesshme të hetuara që lidhen me trafikimin të kryera nga kjo drejtori	Ekzistuese
1.(i).3.	Ndërtimi/forcimi i besimit të publikut te forcat e zbatimit të ligjit dhe vazhdimi i nxitjes së denoncimit të zyrtarëve të korruptuar	MB, Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Numri i çështjeve të hapura mbi bazën e informimit nga publiku	Ekzistuese
1.(i).3.1	Fushatë publike mbi politikën e tolerancës zero dhe vazhdimi i funksionimit të linjës telefonike pa pagesë kundër korrupsionit për publikun, si edhe linja telefonike për antitrafikimin, me qëllim raportimin e rasteve të përfshirjes dhe bashkëpunimit të zyrtarëve	MB, Policia e Shtetit, ZKKA	Në vazhdimësi	Fushatë ndërgjegjësimi për politikën e tolerancës zero dhe bërja publike e linjave të vendosura telefonike. Numri i telefonatave që raportojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e zyrtarëve në trafikimin e qenieve njerëzore	Ekzistuese
1.(i).3.2	Informimi i publikut në lidhje me veprimtaritë e ndërmarra kundër korrupsionit dhe rezultatet e tyre	MB, Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Publikimi i statistikave mbi numrin e ndjekjeve penale kundër zyrtarëve të korruptuar	Ekzistuese

II. MBROJTJA DHE ASISTENCA PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Nr.	AKTIVITETI	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burime
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Forcimi dhe funksionimi i plotë i mekanizmave që kryejnë bashkërendimin për identifikimin, referimin, ndihmën dhe rikthimin/(ri)integrimin për viktimat e (ri)trafikuar.				
	Treguesi/synimi: Mekanizmat kanë të gjitha burimet për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, identifikimin, mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës ndaj viktimave të trafikimit.				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Fuqizimi i “Mekanizmit kombëtar i referimit për viktimat e trafikimit”, si një mekanizëm gjithëpërfshirës, autoritetit përgjegjës, komiteteve rajonale antitrafik, me role, detyra e përgjegjësi të përcaktuara.				
	Treguesi: Marrëveshja e MKR-së e rishikuar; urdhri i autoritetit përgjegjës i rishikuar; urdhri i komiteteve rajonale antitrafik i rishikuar.				
1.(a).1	Të rishikohet Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit	ZKKA, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, IOM, KKSAT, ARSIS, MPJ, AP, ekspertë të fushës	Mars 2011 Prill 2011 Shtator 2011	Krijimi i grupit të punës për rishikimin Organizimi i takimeve Marrëveshja e rishikuar	Ekzistuese
1. (a) 1.1	Të ngrihet grupi i punës për MKR	ZKKA, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, IOM, KKSAT, ARSIS, MPJ, AP	Mars 2011	Grupi i punës është ngritur dhe funksionon	Ekzistuese
1. (a).2	Të rishikohet urdhri për autoritetin përgjegjës ¹	ZKKA, anëtarët e autoritetit përgjegjës, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ, IOM, ekspertë të fushës	Mars 2011 Prill 2011 Shtator 2011	Krijimi i grupit të punës Organizimi i takimeve Urdhri i rishikuar	Ekzistuese
1. (a). 3	Të rishikohet urdhri për Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore ² me qëllim detajimin e detyrave dhe kompetencave të anëtarëve të komiteteve rajonale antitrafik, si dhe zgjerimin e anëtarësisë së Komitetit.	Komitetet rajonale antitrafik, ZKKA, anëtarët e autoritetit përgjegjës, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ, NjMF, njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ekspertë të fushës	Maj 2011 Qershor 2011 Tetor 2011	Krijimi i grupit të punës Organizimi i takimeve Urdhri i rishikuar	Ekzistuese
1. (b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Forcimi i kapacitetit të strukturave që merren me identifikimin, referimin, ndihmën, riintegrimin dhe koordinimin e përpjekjeve antitrafik në vend.				
	Treguesi: Strukturat disponojnë burimet e nevojshme për të kryer punën e tyre.				
1. (b). 1	Të trajnohen anëtarët e autoritetit përgjegjës në bazë të urdhrit të ri të rishikuar (shih më lart), si edhe në bazë të procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit të miratuar	ZKKA, anëtarët e AP, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve	Ekzistuese
1. (b). 2	Të trajnohen anëtarët e komiteteve rajonale antitrafik në bazë të urdhrit të ri të rishikuar (shih më lartë), si edhe në bazë të procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit të miratuar	ZKKA, komitetet rajonale antitrafik, anëtarët e AP, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve	Ekzistuese
1. (b). 2.1	Të krijohet sistemi i administrimit të rasteve të trafikimit në nivel qarku.	ZKKA, komitetet rajonale antitrafik, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ	2012 2011 Në vazhdimësi	Procedura standarde operative për identifikimin, referimin, ndihmën, riintegrimin e viktimave të trafikimit në nivel qarku Trajnim i stafëve të komiteteve rajonale antitrafik lidhur PSO-të e lartpërmendura. Monitorim i zbatimit të PSO-ve në nivel qarku	Ekzistuese
1. (b). 3	Të përmirësohet baza e të dhënave për viktimat e trafikimit	ZKKA, anëtarët e AP, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, MPJ	Në vazhdimësi Në vazhdimësi	Rritje e cilësisë së raporteve që dalin nga baza e të dhënave për viktimat e trafikimit. Raportim i institucionalizuar periodik.	Ekzistuese
2.	SYNIM STRATEGJIK: Sigurimi i identifikimit dhe i referimit të të gjithë viktimave të trafikimit dhe të gjitha formave të shfrytëzimit				
	Treguesi: Rritje e numrit të identifikimeve dhe referimeve të viktimave të trafikimit brenda vendit, në kufi, jashtë vendit dhe vetidentifikimeve.				
2.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Zbatimi i procedurave standarde operative për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit.				

¹ Urdhër i përbashkët “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces” Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme nr.prot.3394/4, datë 17.5.2006 nr.prot.7590, datë 24.5.2006.

² Urdhër nr.139, datë 19.6.2006 “Për krijimin e komiteteve rajonale të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore”.

Nr.	AKTIVITETI	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burime
	Treguesi: Inspektimet në strukturat zbatuese të dokumentit të procedurave standarde operative për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit rezultojnë të suksesshme				
2.(a).1	Të hartohen udhëzimet për strukturat zbatuese të dokumentit të procedurave standarde operative për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit	Strukturat zbatuese, ZKKA, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, IOM, KKSAT, ARSIS	Maj 2011	Udhëzime të shkruara të strukturave zbatuese	Ekzistuese
2. (a). 2	Të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme strukturat zbatuese të dokumentit të procedurave standarde operative për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit	Strukturat zbatuese, ZKKA, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, IOM, KKSAT, ARSIS	Qershor 2011	Plani i trajnimeve	Ekzistuese
2. (a). 3	Të monitorohen aktivitetet e strukturave zbatuese të dokumentit të procedurave standarde operative për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit	Grupi monitorues	Në vazhdimësi	Plani i monitorimit të punës së strukturave zbatuese	Ekzistuese
2. (b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritje e identifikimeve të rasteve të trafikimit brenda vendit.				
	Treguesi: Numri i identifikimeve brenda vendit është rritur.				
2.(b) 1	Të sigurohet prania e një punonjësi social për kryerjen e intervistës formale të identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit	MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS	Në vazhdimësi	Punonjësi i Shërbimit Social Shtetëror është prezent gjatë kryerjes së intervistës formale dhe në rastet emergjente dhe punonjësi social i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, shërbimet janë 24/7	Ekzistuese
2. (b). 2	Të hartohet raporti dhe/ose studimi mbi arritjet dhe problematikat e konstatuara në identifikimin e rasteve të trafikimit brenda vendit	ZKKA, PSH, MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, Avokati i Popullit dhe ekspertë të fushës	Maj 2011	Raporti i arritjeve dhe problematikave të konstatuara në identifikimin e rasteve të trafikimit brenda vendit	Ekzistuese
2. (b).2.1	Të hartohet plani i punës në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të raportit	ZKKA, anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, Komiteti Shtetëror	Qershor 2011	Plan pune në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të raportit	Ekzistuese
2. (b). 3	Të hartohen udhëzimet për zbatimin e PSV-ve për të siguruar identifikimin fillestar të rasteve të trafikimit nga strukturat e: (1) Inspektoratit të Punës; (2) Sistemit arsimor (mësues, psikolog); (3) Mjekut; (4) Struktura të hetimit dhe parandalimit të krimeve; (5) Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve; (6) Administratorët socialë; (7) OJF të licencuara.	MASH, ZKKA MSH, ZKKA MPÇSSHB, ZKKA MSH Policia e Shtetit NJMF Bashkitë Bashkitë	Dhjetor 2011 Dhjetor 2011 Dhjetor 2011 Dhjetor 2011 Dhjetor 2011 Dhjetor 2011	Udhëzime për mësuesit dhe psikologët në shkolla 9-vjeçare dhe shkolla të mesme Udhëzime për mjekët Udhëzime për inspektoratin e punës Udhëzime për punonjësit e strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimit Udhëzime për punonjësit e NJMF Udhëzime për administratorët social	Ekzistuese
2. (b). 4	Të funksionojë linja telefonike falas 0 800 12 12 dhe aksesimi i këtij të fundit edhe nga telefonia celulare.	ZKKA, Policia e Shtetit, OJF	Në vazhdimësi	Spote publicitare Fletëpalosje	Ekzistuese
2. (b). 4. 1	Të trajnohen operatorët e linjës telefonike falas 0 800 12 12 për këshillim	ZKKA, Policia e Shtetit, OJF	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve.	Ekzistuese
2. (b). 4. 2	Të hartohet udhëzimi i trajtimit të rasteve që operatorët trajtojnë në linjën telefonike falas	ZKKA, Policia e Shtetit	Tetor 2011	Udhëzimi i trajtimit të rasteve	Ekzistuese
2. (b) 4.3	Të caktohet një psikolog/punonjës social ne operimin e linjës telefonike	ZKKA, Policia e Shtetit	Janar 2012	Psikologu/punonjësi është pjesë e stafit që operon linjën telefonike pa pagesë	Ekzistuese
2. (c)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritje e identifikimeve të rasteve në kufi dhe siguri i qëndrimit ligjor për të gjithë personat e trafikuar, pavarësisht nga vullneti i tyre për të dëshmuar.				
	Treguesi: Numri i identifikimeve në kufi është rritur. Sigurimi i qëndrimit ligjor.				
2. (c). 1	Të sigurohet identifikimi proaktiv i viktimave të trafikimit si një qasje e re në kuadër dhe të liberalizimit të vizave dhe ngritja e kapaciteteve në këtë drejtim	PSH, MPÇSSHB/SHSSH, ZKKA	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve	Ekzistuese

Nr.	AKTIVITETI	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burime
2. (c). 2	Të sigurohet prania e përhershme e një oficerreje femër për kryerjen identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit në të gjitha pikat e kalimit kufitar	Policia e Shtetit, ZKKA	Në vazhdimësi	Në çdo pikë kufitare ka një oficerre femër specialiste	Ekzistuese
2. (c). 2. 1	Të sigurohet prania e një punonjësi social për kryerjen e intervistës formale të identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit	MPCSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, ZKKA	Në vazhdimësi	Në çdo pikë kufitare ka një punonjës të shërbimit social shtetëror. Punonjësi i Shërbimit Social Shtetëror është prezent gjatë kryerjes së intervistës formale dhe në rastet emergjente dhe punonjësi social i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, shërbimet janë 24/7	Ekzistuese
2. (c). 3	Të sigurohet qëndrimi ligjor i shtetasve të huaj të trafikuar, pavarësisht nga vullneti për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente, në përputhje me Konventën e Këshillit të Europës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore	PSH/Polica e Migracionit dhe Kufirit	Në vazhdimësi	Viktimat e huaja të trafikimit përfitojnë sigurim të qëndrimit ligjor.	Ekzistuese
2. (d)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritje e identifikimeve të rasteve jashtë vendit.				
Treguesit: Numri i identifikimeve jashtë vendit është rritur.					
2(d)1	Të zbatohet marrëveshja me Greqinë "Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit"	MB/ZKKA	Në vazhdimësi	Plan monitorimi Raport mbi zbatimin e marrëveshjes Numri i fëmijëve	Ekzistuese
2. (d). 2	Të hartohen udhëzimet në bazë të PSV-ve për të siguruar identifikimin e rasteve të trafikimit jashtë vendit. Vendosija e kontakteve me OJF-të dhe shoqata shqiptare dhe/ose të huaja që merren me këtë çështje	MPJ, ZKKA	Dhjetor 2011	Udhëzime të shkruara për punonjësit e trupit diplomatik. Rritje e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit	Ekzistuese
2.(d). 2.1	Të hartohen materiale informuese, këshilla, si dhe ndihmë konkrete për shqiptarët jashtë shtetit (viktimat), nëpërmjet zyrave konsullore shqiptare jashtë vendit	MPJ, ZKKA	Në vazhdimësi	Materiale informuese Plani i shpërndarjes	Ekzistuese
2.(d). 2.2	Të organizohen trajnime për punonjësit e zyrave tona konsullore mbi zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit	MPJ, ZKKA, IOM	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve	Ekzistuese
2. (d). 2.3	Të sigurohet një shpërndarje e gjerë e informacionit/materialeve për viktimat e mundshme shqiptare jashtë shtetit	MPJ, ZKKA	Në vazhdimësi	Plani i shpërndarjes	Ekzistuese
2. (d). 3	Të negociohen marrëveshje dypalëshe për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit	ZKKA, MPJ	Në vazhdimësi	Marrëveshje dypalëshe me: Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë.	Ekzistuese
2. (e)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Nxitja e vetëidentifikimit të personave të trafikuar.				
Treguesi: Numri i vetëidentifikimeve.					
2. (e). 1	Të funksionojë linja telefonike falas. Shtirirja dhe me operatorët celular dhe nga jashtë vendit	ZKKA, PSH, organizata ndërkombëtare	Qershor 2012	Linja telefonike falas funksionon dhe nga operatorët celular jashtë vendit Numri i rasteve	Ekzistuese
2. (e). 2	Të kryhen fushata të synuara (në bazë të vlerësimeve) në bashkësi, për të rritur ndërgjegjësimin mbi trafikimin e qenieve njerëzore, shërbimet e vlefshme për personat e trafikuar dhe mënyrat sesi ato mund të përfitohen	ZKKA, KRAT	Në vazhdimësi	Plani i fushatave të synuara në bashkësi	Ekzistuese
2. (e). 3	Të përgatiten dhe shpërndahen materiale informuese mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe shpërndarja e tyre në vende strategjike (përfshi qendrat e bashkësive, zyrat e ndihmës sociale, komisarariatet e policisë, shkollat etj.)	ZKKA, ON	Në vazhdimësi	Materiale informuese	Ekzistuese

Nr.	AKTIVITETI	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burime
3.	SYNIM STRATEGJIK: Sigurimi i një mbështetjeje sociale dhe rritja e mundësive mbështetëse gjithëpërfshirëse për të gjitha viktimat e trafikimit, në përputhje me nevojat e tyre individuale pavarësisht vullnetit për të bashkëpunuar me autoritetet e zbatimit të ligjit.				
	Treguesit: Numri i personave të trafikuar që nuk kanë vullnetin të bashkëpunojnë me autoritetet dhe të dëshmojnë dhe që marrin ndihmë e mbështetje sociale; numri i personave të trafikuar që kanë vullnetin të dëshmojnë dhe që marrin ndihmë e mbështetje sociale				
3. (a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ofrimi i shërbimeve të cilësisë më të lartë në strehëzat/qendrat e pritjes dhe riintegritimit për viktimat e trafikimit. Shërbimet ofrojnë garanci të sigurisë fizike dhe ndihmë të plotë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore të gjitha viktimave të trafikimit.				
	Treguesit: Plane mbështetëse për strehëzat. Inspektimet tregojnë cilësi të lartë të shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit.				
3 (a) 1	Të sigurohen burimet e nevojshme për vazhdimësinë e dhënies së shërbimeve cilësore për viktimat e trafikimit	Komiteti Shtetëror, ZKKA, MPÇSSHB, PSH, MPJ, KKSAT, ARSIS	Janar 2012	Plani mbështetës	Ekzistuese
3. (a). 2	Të kryhen inspektime periodike të ofruesve publikë dhe privatë për zbatimin e standardeve të shërbimeve për personat e trafikuar ose viktimat e mundshme të trafikimit	MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ARSIS, ZKKA	Në vazhdimësi	Raporte të inspektimeve	Ekzistuese
3. (a). 2.1	Të hartohen plane mbështetëse lidhur me implementimin sa më të mirë të standardeve të shërbimeve për personat e trafikuar ose viktimat e mundshme të trafikimit.	MPÇSSHB/SHSSH, KKSAT, ZKKA	Janar 2012	Plani mbështetës	Ekzistuese
3. (a). 3	Të sigurohet funksionimi dhe mbështetja shtetërore ndaj Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik	MPÇSSHB, ZKKA, SHSSH, PSH, KKSAT, MPJ	Në vazhdimësi	Plani mbështetës	Ekzistuese
3. (b)	Objektivi specifik: Rritje e shërbimeve mbështetëse për ndihmë të plotë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore personave të trafikuar.				
	Treguesit: Ekzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit, memorandumave të bashkëpunimit mes KKSAT dhe agjencive shtetërore. (Ministritë së Arsimit dhe Shkencës, Ministritë së Shëndetësisë, bashkive).				
3. (b). 1	Të negociohen dhe nënshkruhen marrëveshje të bashkëpunimit mes KKSAT, ARSIS dhe Ministritë së Arsimit dhe Shkencës.	MASH, KKSAT, ARSIS, ZKKA	Dhjetor 2011 Në vazhdimësi	Nënshkrimi i marrëveshjes Zbatimi i marrëveshjes	Ekzistuese
3. (b). 2	Të negociohen dhe nënshkruhen Marrëveshje të bashkëpunimit mes KKSAT, ARSIS dhe Ministritë së Shëndetësisë.	MSH, KKSAT, ARSIS, ZKKA	Dhjetor 2011 Në vazhdimësi	Nënshkrimi i marrëveshjes. Zbatimi i marrëveshjes	Ekzistuese
3. (b). 3	Të ngrihet një grup i përbashkët pune nëpërmjet MB, MSH dhe Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për hartimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave të ri, sipas nenit 8, pika 3 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"	MSH, MB, ISKSH	Dhjetor 2011	Miratim i vendimit të Këshillit të Ministrave	Ekzistuese
3. (c)	Objektivi specifik: Rritje e mundësive riintegruese në punësim, strehim për një integrim sa më të plotë të viktimave të trafikimit dhe për të siguruar parandalimin e ritrafikimit.				
	Treguesit: Ekzistenca e planeve për punësimin, strehimin dhe dhënien e ndihmës ekonomike për viktimave të trafikimit. Numri i viktimave që kanë përfituar punësim, strehim, ndihmën ekonomike.				
3. (c). 1	Të hartohet plani për lehtësimin/mbështetjen e procesit të punësimit të viktimave të trafikimit.	Koalicioni shtetëror, MPÇSSHB, ZKKA, KKSAT, biznese private, ON	Shkurt 2012	Plani mbështetës	Ekzistuese
3. (c). 2	Të hartohet plani për lehtësimin/mbështetjen e procesit të strehimit të viktimave të trafikimit.	Koalicioni Shtetëror, MPPT, ZKKA, KKSAT	Shkurt 2012	Plani mbështetës	Ekzistuese
3. (c). 3	Të sigurohet vazhdimësia e përfitimit të ndihmës ekonomike nga viktimat e trafikimit	MPÇSSHB, ZKKA	Në vazhdimësi	Viktimat e trafikimit përfitojnë ndihmë ekonomike	Ekzistuese
4.	SYNIMI STRATEGJIK: Siguri e jetës me mbrojtje të veçantë ndaj viktimave që bashkëpunojnë me organet e drejtësisë gjatë procesit dhe pas tij.				
	Treguesit: Numri i viktimave që bëhen pjesë e procese gjyqësore. Numri i viktimave për të cilat ka një plan mbrojtjeje.				
4. (a)	Objektivi specifik: Sigurimi i standardeve të mbrojtjes për të gjitha viktimat përpara, gjatë dhe pas procedimit penal.				
	Treguesit: Përmbajtja e protokolleve të çështjeve dhe planet e mbrojtjes.				
4. (a). 1	Të sigurohet zbatimi i ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Numri i viktimave të trafikimit që kanë marrë mbrojtje	Ekzistuese
4.(a). 2	Zhvillim i trajnimeve mbi standardet për mbrojtjen e viktimave, të cilat paraqiten si dëshmitarë	Shkolla e Magjistraturës, PP, PSH GJKR dhe ZKKA	Në vazhdimësi	Plani i trajnimeve	Ekzistuese

Nr.	AKTIVITETI	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burime
4.(a).3	Të sigurohet mbrojtja e dëshmitarëve në Gjykatën e Krimeve të Rënda, si dhe në gjykatat e tjera, Prokurorinë e Përgjithshme, polici (nëpërmjet udhëzimeve, pajisjeve për lidhje video, zonave të veçanta të pritjes etj.)	DPPSH, PP, GJKR	Në vazhdimësi	Sigurimi dhe vënia në përdorim e pajisjeve të sigurisë teknike Numri i çështjeve kur janë përdorur këto teknika	Ekzistuese
4. (b)	Objektivi specifik: Nxitje e viktimave të trafikimit për të bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit. Treguesit: Rritje e numrit të viktimave të trafikimit që bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit. Përmirësimi i programit të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve.				
4. (b). 1	Të fuqizohet roli i koordinatorit për viktimit e trafikimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.	PKR, ZKKA	Në vazhdimësi	Termet e referencës Numri i rasteve të viktimave të asistuar	Ekzistuese
4. (b). 2	Forcimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunatorëve të Drejtësisë.	PSH	Në vazhdimësi	Numri i personave të trajnuar Burime të mjaftueshme	Ekzistuese
4. (b). 3	Të sigurohet zbatim i marrëveshjeve të bashkëpunimit për rialokimin e viktimave/dëshmitarëve me strukturat homologe jashtë vendit.	PSH	Në vazhdimësi	Marrëveshjet të jenë nënshkruar e zbatuar. Numri i viktimave/dëshmitarëve të rialokuar. Të monitorohet zbatim i masave të veçanta të sigurisë.	Ekzistuese
4. (c)	Objektivi specifik: Të sigurohet që personat e trafikuar të mos ndalohen, akuzohen apo ndiqen për shkelje të ligjeve të imigrimit apo për veprimtari në të cilat ata janë përfshirë si pasojë e të qenit persona të trafikuar. Treguesit: Numri i çështjeve të raportuara për riviktimizimin, ndalimin, ndjekjen apo akuzimin e viktimave të trafikimit.				
4.(c).1	Lëshimi i udhëzimeve dhe PSV-ve për strukturat e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorin për mosndëshkimin e viktimave për shkeljen e ligjeve të imigrimit apo për veprimtari në të cilat ata janë përfshirë si pasojë e të qenit persona të trafikuar,	MD, PP, PSH, ZKKA dhe partnerët.	2011 2011 2011	Hartimi i udhëzimeve Shpërndarja e udhëzimeve Plan trajnimi Numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve të identifikuar, të cilët janë të njohur me udhëzimet.	Ekzistuese
4. (d)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të sigurohet një mbulim i kujdesshëm nga ana e mediave i çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë që të mos paraqitet imazhi, identiteti, vendndodhja apo informacioni personal i viktimave të trafikuar. Treguesit: një mbulim më të kujdesshëm dhe ligjërish të përshtatshëm nga ana e mediave për çështjet e trafikimit;				
4.(d).1	Të kryhen trajnime për të drejtat e njeriut, privatësinë me profesionistë të mediave që mbulojnë çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	ZKKA, Instituti i Medias, ON	Në vazhdimësi	Plan trajnimi Numri i profesionistëve të mediave, të cilët njohin detyrimet e tyre për raportimin sensitiv. Analizë e raporteve të medias.	Ekzistuese

III. PARANDALIMI

Nr.	Vepimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Rritja e ndërgjegjësimit publik, veçanërisht e grupeve në nevojë dhe atyre në rrezik, për situatat reale të migracionit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe rreziqet e përfshira, duke u përqendruar posaçërisht te trafikimi i brendshëm, trafikimi i fëmijëve dhe trafikimi me qëllim të gjitha format e shfrytëzimit.				
	Treguesit: përqindja e popullsisë që mund të përshkruajë trafikimin e qenieve njerëzore, qëllimet kryesore për të cilat trafikohen personat, si dhe rrugët kryesore të rekrutimit.				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ndërgjegjësimit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, realitetet e migracionit, si edhe alternativat ekonomike ndaj trafikimit; nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit që synojnë publikun në përgjithësi, grupet në rrezik, klientët dhe shfrytëzuesit e mundshëm, të gjithë aktorët që punojnë me grupet në rrezik.				
1.(a).1	Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse për trafikimin e qenieve njerëzore, bazuar në kërkimin mbi audiencën e synuar, me materiale dhe mesazhe të përditësuara sistematikisht.	ZKKA, KRAT me mbështetjen e shoqërisë civile	Në vazhdimësi	Numri i fushatave të organizuara; Numri i publikimeve; Vëllimi i materialeve të shpërndara. Fushatat e ndërgjegjësimit janë të koordinuara dhe të harmonizuara me qëllim përforcimin e mesazhit dhe shmangien e mbivendosjes.	Ekzistuese
1.(a).2	Organizimi i fushatave të vazhdueshme të ndërgjegjësimit, duke u përqendruar te trafikimi i brendshëm.	ZKKA, KRAT në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit mbi trafikimin e brendshëm. Numri i pjesëmarrësve	Ekzistuese
1.(a).3	Informimi/sensibilizimi i strukturave shtetërore, nëpërmjet takimeve konsultative, trajnimeve, për trafikimin për qëllime pune dhe lypje të detyruar.	Policia e shtetit, Qendra e Formimit Policor, ZKKA, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i takimeve /aktiviteteve/trajnimeve të organizuara Numri i pjesëmarrësve	Ekzistuese
1.(a).4	Zhvillimi i fushatave të vazhdueshme të ndërgjegjësimit, përfshirë informacion mbi alternativat ekonomike dhe ndihmën ekzistuese, drejtuar shtresave dhe bashkësive më të rrezikuara.	KRAT, pushteti vendor, në bashkëpunim me ZKKA-në dhe shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Ekzistenca e vlerësimit të grupeve më në rrezik dhe përcaktimi i përparësive; Ekzistenca e përkufizimeve; standarde për grupet e rrezikuara; Përgatitja dhe zbatimi i fushatave të përshtatshme të ndërgjegjësimit; Rritja e përqindjes së grupit të synuar të popullsisë që mund të përmendë qëllimet kryesore për të cilat trafikohen personat dhe rrugët nëpërmjet të cilave rekrutohen njerëzit	Ekzistuese
1.(a).5	Rritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore që punojnë me kategoritë në rrezik nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe shpërndarjes së udhëzimeve dhe broshurave informative për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.	Ministritë e linjës ZKKA, në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i personave që punojnë me grupet në rrezik, të cilët mund të përshkruajnë trafikimin e qenieve njerëzore (format e rekrutimit, shfrytëzimit etj.), treguesit e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mënyrat e identifikimit (përmes udhëzimeve të intervistimit) dhe referimi të shërbimit e nevojshme. Ekzistenca e moduleve të trajnimit/PSV/udhëzimeve. Materiale/fletëpalosje informuese të shpërndara	Ekzistuese
1.(a).6	Sigurimi i funksionimit 24-orësh të linjës telefonike pa pagesë 08001212.	MB/ZKKA	Në vazhdimësi	Linja funksionale 24-orëshe	Ekzistuese
1.(a). 6.1	Përgatitja e raporteve për thirrjet e marra dhe raportimi periodik i ZKKA-së.	Policia e Shtetit/salla operative, ZKKA	Çdo tre muaj	Numri i thirrjeve telefonike në linjë dhe historiku i thirrjeve. Raportet e hartuara	Ekzistuese
1.(a). 6.2	Promovimi i vazhdueshëm i linjës 08001212 nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve, posterave etj. në PKK, vende publike, institucione publike.	MB/ZKKA	Në vazhdimësi	Nr. i vizitave në faqen e internetit. Numri i fushatave; fletëpalosjet dhe posterat e përgatitura	Ekzistuese
1.(a).7	Organizimi i fushatave sensibilizuese për të drejtat e punësimit me fokus punëmarrësit dhe punëdhënësit, përfshi organizimin e fushatave të synuara mes punëtorëve migrantë (femra dhe meshkuj).	MPÇSSHB, Inspektorati i Punës, sindikatat e punëmarrësve, Avokati i Popullit, ILO, IOM dhe partnerë të tjerë	Në vazhdimësi	Numri i fushatave të organizuara. Punëtorët migrantë njohin të drejtat e tyre dhe dinë ku të drejtohen për të marrë informacion	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
1.(a).8	Zhvillimi i fushatave që synojnë kërkesën për punën e detyruar, shfrytëzimin seksual, përfshi: - Fushata që synojnë klientët e punëtorëve të seksit (për t'i ndërgjegjësuar ndaj trafikimit, si edhe si të identifikojnë një grua të trafikuar dhe si ta ndihmojnë atë).	ZKKA, në bashkëpunim me shoqërinë civile	2011-2012	Numri i fushatave të organizuara; Numri i pjesëmarrësve Numri i viktimave të identifikuar nga klientët ³	Ekzistuese
1.(a).9	Vazhdimi i fushatës kundër lypjes së detyruar.	MPÇSSHB, MASH, ZKKA, Avokati i Popullit, BKTF, UNICEF, shoqëria civile	Në vazhdimësi	Numri i fëmijëve të larguar nga gjendja e rrugës. Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike, apo përfitime të tjera nga shteti. Sondazh që rezulton në uljen e përfitimeve nga lypja	Ekzistuese
1.(a).10	Promovimi i mëtejshëm i zbatimit të Kodit të Sjelljes në Turizëm	MTKRS, Shoqata Shqiptare e Turizmit, ZKKA, OSBE	Në vazhdimësi	Numri i operatorëve turistikë, të cilët e njohin dhe e zbatojnë Kodin e Sjelljes	
1.(a).11	Ndërgjegjësimi dhe trajnimi për çështjet e luftës kundër trafikimit i ushtarëve shqiptarë përpara dislokimit në misionet ushtarake dhe paqeruajtëse jashtë vendit	MM, ZKKA dhe partnerët	Në vazhdimësi	Ekzistenca e modulit antitrafikim Përqindja e të gjithë ushtarëve që kanë marrë trajnim për çështjet e antitrafikimit përpara dislokimit jashtë vendit	
1. (b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Monitorimi i vazhdueshëm i medias dhe internetit për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe ndërgjegjësimi i medias.				
1. (b). 1	Monitorimi i përmbajtjes së njoftimeve/ofertave për punë në media (gazeta, tv, radio dhe internet) që përmbajnë mesazhe indirekte ose të drejtpërdrejta nxitëse për prostitucion apo aktivitetet e tjera të jashtëligjshme dhe marrja e masave ndaj tyre.	Policia e Shtetit/Sektori kundër Krimit Kompjuterik	Në vazhdimësi	Rastet e ndjekura/rezultatet e arritura	Ekzistuese
1.(b).2	Rritja e ndërgjegjësimi të gazetarëve për të raportuar saktë, bazuar në fakte, të kujdesshëm ndaj mënyrës jostigmatizuese, duke rritur kështu ndërgjegjësimin publik mbi trafikimin dhe duke mbështetur ndërhyrjet dhe viktimat.	Instituti i Medias, KKRTSH, ZKKA, ATSH-ja në bashkëpunim me përfaqësuesit e medias dhe shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i gazetarëve që kanë njohuri mbi çështjet e antitrafikimit. Zbatimi i Kodit të Etikës	Ekzistuese
1.(b).3	Organizimi i trajnimeve me mediat.	Instituti i Medias, në bashkëpunim me ZKKA dhe shoqërinë civile	Çdo vit	Planet e trajnimit të përgatitura Numri i trajnimeve Numri i të trajnuarve	Ekzistuese
1.(c)	OBJEKTIVI SPECIFIK: ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i fëmijëve dhe të rinjve për trafikimin, duke pasuruar kurrikulën shkollore me temat e trafikimit të qenieve njerëzore, të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore etj.				
	Treguesit: përqindja e shkollave (sipas nivelit të arsimit) që përdorin modulën e që trajton çështjen e trafikimit; përqindja e nxënësve (sipas nivelit të arsimit/moshës), të cilët mund të përmendin qëllimet kryesore për të cilat trafikohen personat dhe rrugët kryesore nëpërmjet të cilave rekrutohen njerëzit				
1.(c).1	Pasurimi i kurrikulës shkollore me temat e trafikimit të qenieve njerëzore (përfshi edhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje, si edhe edukimin seksual).	MASH (Instituti i Kurrikulave), ZKKA, me shoqërinë civile	Brenda vitit 2011	Ekzistenca e akteve ligjore që sanksionojnë përfshirjen e detyruar të temave kundër trafikimit, në kurrikulën shkollore të arsimit 9-vjeçar.	Ekzistuese
1.(c).1.1	Organizimi i trajnimit të punonjësve të arsimit për trajtimin e këtyre temave.	MASH (Instituti i Kurrikulave), ZKKA, me shoqërinë civile	Brenda vitit 2011	Ekzistenca e moduleve. Ekzistenca e moduleve trajnuese antitrafikim dhe trajnimi i mësuesve (të paktën nga një mësues për çdo shkollë ka kryer me sukses trajnimin në modulën e antitrafikimit dhe siguron përditësimin dhe zbatimin e tij sistematik)	Ekzistuese
1.(c).2	Përfshirja e trajnimit për ndërgjegjësimin ndaj trafikimit në programet e Shtëpive të Fëmijës (jetimoreve)	MPÇSSHB, MASH	Brenda vitit 2011	Përfshirja e trajnimit të detyruar antitrafikim në programet e Shtëpive të Fëmijës (jetimoreve)	
1.(c).3	Përfshirja e trajnimit për ndërgjegjësimin ndaj trafikimit në programet për aftësitë për jetën /formimin profesional të	MASH, MPÇSSHB asistuar nga ZKKA	Brenda vitit 2011	Ekzistenca e moduleve antitrafikim të përfshira programet për aftësitë jetësore /arsimimin /formimin profesional	Ekzistuese

³ Klient quhet çdo person që paguan për të përfituar një shërbim të caktuar. Në rastin konkret, klientë janë personat që paguajnë për shërbimin seksual.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	personave që braktisin shkollën.			të personave që braktisin shkollën	
1.(c).4	Sigurimi i ndërgjegjësimit të fëmijëve e prindërve të tyre për çështjet e trafikimit në komunitet.	KRAT, NJMF, ZKKA, me bashkitë/komunat, dhe shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Përqindja e fëmijëve dhe prindërve të informuar mbi trafikimin dhe që mund të identifikojnë të paktën tre tregues të trafikimit.	Ekzistuese
1.(c).5	Përgatitja e materialeve informuese, edukuese për fëmijët e shkollave dhe shpërndarja e tyre, në shkolla, institucione të përkujdesit social etj.	ZKKA, MASH në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në 2012	Materialet e shpërndara	Ekzistuese
2.	SYNIMI STRATEGJIK: Reduktimi i ekspozimit ndaj trafikimit dhe rritja e përfshirjes sociale				
2.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Trajtimi i çështjeve që qëndrojnë në themel të trafikimit, përfshi varfërinë dhe papunësinë, diskriminimin e grave, pakicave, fëmijëve, migrantëve dhe grupet e tjera në nevojë dhe rritja e mundësive ekonomike për grupet në nevojë ose në rrezik nëpërmjet punësimit ose veprimtarive të tjera që gjenerojnë të ardhura.				
	Treguesit: Pjesëmarrja e meshkujve/femrave në tregun e punës dhe e grupeve të identifikuara në rrezik; numri dhe përqindja e personave të identifikuar në nevojë që kanë gjetur punë ose janë përfshirë në veprimtari që sjellin të ardhura (në bazë vjetore)				
2.(a).1	Rritja e mundësive për punësim dhe gjetja e vendeve të punës për grupet në nevojë.	MPÇSSHB, pushteti vendor	Në vazhdimësi	Synimi: rritja e numrit dhe vëllimit të programeve qeveritare që mbështesin personat në rrezik trafikimi për gjetjen e një vendi pune. Ekzistenca e programeve qeveritare për krijimin e veprimtarive që sjellin të ardhura. Numri i personave në nevojë dhe në rrezik, të cilët gjejnë punë nëpërmjet zyrave të punës (në bazë vjetore).	Ekzistuese
2.(a).2	- Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit të zyrave rajonale të punës dhe degëve të tyre lokale, përfshi: - Trajnimin për aftësitë sociale, aftësitë për kontaktet në bazë dhe aftësitë për gjetjen e punës; trajnim për ndërgjegjësimin mbi çështjet e antitrafikimit të qenieve njerëzore dhe për grupet në nevojë; - Trajnimin në kryerjen e vlerësimeve sistematike të tregut të punës; - Rishikimin e termave të referencës për të siguruar mandatin për të trajtuar aktivisht personat e trafikuar dhe ata në rrezik.	MPÇSSHB (drejtoritë rajonale të formimit profesional publik, zyrat rajonale të punësimit) me partnerët ndërkombëtarë (ILO, KKSAT)	Brenda 2011	Numri i personave në nevojë dhe atyre në rrezik që gjejnë punë nëpërmjet zyrave të punës (në bazë vjetore). Synimi: Përdorimi në rritje i zyrave rajonale të punës nga personat në rrezik trafikimi. Ekzistenca e raporteve (dyvjeçare) mbi tregun e punës. Ekzistenca e termave të referencës.	Ekzistuese
2.(a).3	Vazhdimi dhe zgjerimi i programeve për të nxitur punësimin e punëkërkueseve femra dhe të grupeve të tjera në nevojë, si dhe ngritja e programeve të veçanta shtesë të punësimit bazuar në vlerësimin e nevojave	MPÇSSHB (zyrat rajonale të punësimit) dhe partnerët	Në vazhdimësi	Numri i personave sipas kategorive që përfitojnë nga skema. Ekzistenca e skemave shtesë të punësimit për grupet në nevojë.	Ekzistuese
2.(a).3	Vazhdimi i zbatimit dhe zhvillimi i trajnimeve profesionale shtesë me synim grupet në rrezik (vajzat e reja, pakicat, bashkësitë e reja joformale), në sektorët me interes për përfituesit dhe për të cilët ka kërkesë, përfshirë aftësitë e përgjithshme për kërkimin e punës, aftësitë profesionale.	MPÇSSHB, KRAT, ZKKA	Në vazhdimësi	Nevojat parësore të identifikuara dhe trajnime shtesë të krijuara sipas nevojave. Ekzistenca e programeve për aftësitë profesionale dhe jetësore për grupet dhe personat në nevojë të identifikuar dhe ekzistenca e programeve periodike për grupet në nevojë.	Ekzistuese
2.(a).4	Informimi i publikut dhe veçanërisht i grupeve në nevojë rreth ekzistencës së programeve të punësimit dhe mbështetje shtesë për ta përmes zyrave të punës	MPÇSSHB (zyrat rajonale të punës), KRAT	Në vazhdimësi	Numri i broshurave informuese të shpërndara. Përqindja e personave në nevojë që janë në dijeni të programeve të përkrahjes.	Ekzistuese
2.(a).5	Nxitja e vetëpunësimit të grupeve në rrezik dhe në nevojë	MPÇSSHB, me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i personave në nevojë dhe në rrezik (dhe përqindja e të gjithë personave të identifikuar) të përfshirë në veprimtari fitimprurëse (në vit).	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
2.(a).5.1	Vazhdimi i zbatimit të skemave ekzistuese të mikrokredive për grupet në nevojë dhe personat e trafikuar, dhe ngritja e skemave të reja (bazuar në analizën e nevojave)	MPÇSSHB, Institucionet e Mikrokredive me partnerët (ILO-MIGRANT, OSBE, TdH, World Vision)	Brenda 2012	Numri dhe përqindja e pjesëmarrësve në program që kanë rritje të konsiderueshme të të ardhurave të fituara në nivel lokal. Synimi: rritja e numrit dhe e vëllimit të programeve qeveritare në përkrahje të personave në rrezik trafikimi në veprimtari fitimprurëse	Ekzistuese
2.(a).6	Krijimi i më shumë mundësive për punësim të ligjshëm jashtë shtetit përmes marrëveshjeve për punësim sezonal (në linjë me Strategjinë Kombëtare për Migracionin) me shtetet europiane, duke mbajtur parasysh mbrojtjen dhe të drejtat e punëtorëve emigrantë (veçanërisht që lejet e punës të mos jenë të lidhura vetëm me një punëdhënës), duke pasur në fokus grupet në nevojë.	MPÇSSHB (Drejtorja e Migracionit), MPJ, PSH (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), dhe partnerët (IOM etj.)	Brenda 2012	Ekzistenca e marrëveshjeve të punësimit sezonal me Italinë, Greqinë dhe me shtete të tjera të BE-së. Synimi: Rritja e numrit të vendeve të punës përmes marrëveshjeve me vendet pritëse.	Ekzistuese
2.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e përfshirjes shoqërore përmes përmirësimit të aftësive për jetën, si dhe zhvillimit të komunitetit.				
2.(b).1	Zhvillimi i një skeme të qëndrueshme për dhënie e asistencës sociale familjeve në nevojë.	MPÇSSHB, MASH	Brenda 2012	Skema për asistencën sociale për familjet në nevojë e miratuar nga Qeveria. Zbatimi i skemës	Ekzistuese
2.(b).2	Ulja e numrit të personave të paregjistruar, sidomos e asaj rome dhe fëmijëve në gjendje rruge, si bazë për regjistrimin në shkolla dhe përfshirjen sociale. Krijimi i lehtësimeve të regjistrimit brenda afatit ligjor. Nxitja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Zyrës së Gjendjes Civile për të siguruar listat e nxënësve që fillojnë shkollën për herë të parë (shih më poshtë)	MB, BKTF, organizatat me bazë në komunitet, me mbështetjen e OSBE-së dhe USAID-it	Brenda 2012	Përqindja e fëmijëve të rrugës dhe fëmijëve romë të regjistruar në shkollë. Shkëmbimi i institucionalizuar i të dhënave mes zyrave të gjendjes civile dhe Ministrisë së Arsimit mbi nxënësit që fillojnë shkollën (çdo prill)	Ekzistuese
2.(b).3	Institucionalizimi i sistemit të "mbrojtësve të fëmijëve" në shkolla (bazuar në praktikën më të mira të TdH, ILO-IPEC, UNICEF, World Vision etj.); duke rritur kështu përkrahjen dhe këshillimin ndaj fëmijëve/të rinjve, për të dalluar rastet në rrezik dhe për të marrë masat e duhura (me NJPF-të) ⁴	MASH (drejtoritë arsimore rajonale), MPÇSSHB, me grupin kombëtar të punës për mbrojtjen e fëmijëve (përbërë nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, BKTF, Save the Children, TdH, ILO-IPEC, UNICEF, World Vision)	Brenda 2012	Ekzistenca e planeve të punës për trajnimin e pikave të kontaktit/mbrojtësve të fëmijëve. Ekzistenca e mbrojtësve të fëmijëve të paktën në shkollat më të prekura (sipas vlerësimit). Synimi: të paktën një pikë kontakti i trajnuar dhe/ose psikolog i trajnuar caktohen si 'mbrojtës i fëmijëve' me kohë të plotë në çdo shkollë dhe lidhen me mekanizmat vendorë të referimit	Ekzistuese
2.(b).4	Hartimi i programeve për arsimim plotësues dhe organizimi i trajnimeve profesionale për ata që kanë braktisur shkollën, të rinjtë dhe të rejtat (të shtrihet modeli i programit 'Shans i dytë');	MASH, MPÇSSHB shoqërinë civile	Brenda 2011	Ekzistenca e programeve të veçanta për të larguarit nga shkolla në mbarë vendin. Numri dhe përqindja e të larguarve nga shkolla (meshkuj/femra) që marrin pjesë në programe. Ekzistenca e programeve që përmbajnë informacion për parandalimin e trafikimit dhe përkrahje afatgjatë (asistencë për aftësitë në punë dhe për gjetjen e punës, asistencë për vazhdimin e arsimit të mëtejshëm dhe/ose për përvetësimin e aftësive jetësore; informacion rreth strehëzave të disponueshme të emergjencës)	Ekzistuese
2.(b).5.	Nxitja dhe krijimi i grupeve ndërdisiplinore me bazë në komunitet dhe i grupeve këshillimore në komunitet	KRAT, bashkitë/komunat, WV, organizatat me bazë në komunitet, drejtuesit e	Brenda 2011	Synimi: të paktën 10 organizata me bazë në komunitet (OBK)/grupe këshillimore në Komunitet (GKK) janë operative	Ekzistuese

⁴ Për më shumë, shih Strategjinë kundër Trafikimit të Fëmijëve.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	(GKK); për t'u përfshirë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive me bazë në komunitet, arsim dhe për të shërbyer si pikë kontakti brenda mekanizmit të tyre vendor të referimit (krahas punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve dhe psikologut të shkollës)	komunitetit		në komunitetet rome dhe egjiptiane dhe të përfshira në sistemet vendore për mbrojtjen e fëmijëve dhe në mekanizmat e referimit. Deri në 2011-ën, organizatat me bazë në komunitet dhe grupet këshillimore në komunitet ekzistojnë në mbarë vendin.	
2.(b).5.1	Nxjtja dhe sigurimi i zbatimit të vazhdueshëm të programeve dhe veprimtarive për zhvillimin dhe përkrahjen e komuniteteve të synuara, përfshirë: - veprimtari edukative dhe psikologjike (kopsht, kampe verore, veprimtari kulturore), - seanca sensibilizimi, - trajnime profesionale dhe përkrahje për gjetjen e punës, - veprimtari fitimprurëse për nënat - skema mikrokredie , - asistencë sociale, - programe për fuqizim personal për gratë dhe të rinjtë (përfshirë të drejtat e njeriut dhe aftësitë jetësore).	KRAT, bashkitë/komunat, ZKKA, me OJF-të me bazë në komunitet, dhe partnerët ndërkombëtarë (Tdh, Save the Children, UNICEF, ILO-IPEC, UNDP, World Vision etj.)	Në vazhdimësi	Ekzistenca e programeve për zhvillimin e komunitetit në të gjitha komunitetet në nevojë të identifikuar. Sigurohet financim më afatgjatë për organizatat me bazë në komunitet dhe veprimtaritë në komunitet .	Ekzistuese
3	SYNIMI STRATEGJIK: Institucionalizimi i mekanizmave të mbrojtjes parandaluese dhe përkrahjes në nivel bashkie/komune për grupet në nevojë dhe në rrezik trafikimi, si dhe identifikimi dhe sigurimi i masave parandaluese për individët në nevojë				
3.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të krijohen/forcohen mekanizmat koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik dhe të sigurohen ndërhyrjet parandaluese dhe mbështetëse si pjesë e "Mekanizmit kombëtar të referimit" ⁵				
	Treguesit: numri i personave në rrezik, të cilët janë evidentuar dhe ndihmuar sipas moshës, seksit, rajonit, bashkisë, numrit vendor funksional të mekanizmit të referimit dhe sistemeve të menaxhimit të rasteve.				
3.(a).1	Krijimi i sistemeve të menaxhimit të rasteve në nivel bashkie/komune për të evidentuar dhe ndihmuar personat në nevojë dhe ata të trafikuar dhe për të evidentuar grupe/komunitete në nevojë, ku të përfshihen: - Njësitë e integruara për ndihmën sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve. - Sistemi i menaxhimit të rasteve; - Grupe/sisteme lokale ndërdisiplinore referimi dhe bashkërendimi, ku të marrin pjesë të gjithë aktorët përkatës (pikat e kontaktit në shkolla/mbrojtësit e fëmijëve, organizatat komunitare/grupet këshilluese në komunitet, policia, inspektorët e punës etj.) ⁶	Bashkitë/komunat, me mbështetjen e MPCSSHB, MASH, MSH, KRAT, AP, ZKKA dhe partnerët ndërkombëtarë	Brenda 2011	Ekzistenca e sistemit ndërdisiplinor të referimit dhe bashkërendimit dhe e planit të sistemit të koordinimit në të gjitha bashkitë/komunat	Ekzistuese
3.(a).1.1	Zbatimi i procedurave standarde të veprimtarive për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Trajnimi i aktorëve përgjegjës për zbatimin e tyre.	Anëtarët e MKR-së/strukturat e tyre në nivel vendor, AP, ZKKA, dhe shoqëria civile	Brenda 6-mujorit të parë të 2011	Miratimi i PSV-ve. Trajnimit e organizuara Numri i të trajnuarve	Ekzistuese
3.(a).1.2.	Përmirësimi i Marrëveshjes së MKR-së.	Anëtarët e MKR-së, AP dhe ZKKA	Brenda 2011	Marrëveshja e MKR e përmirësuar	Ekzistuese
3.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të sigurohet disponueshmëria e shërbimeve të përshtatshme dhe e mbështetjes për grupet dhe personat në nevojë dhe në rrezik.				
	Treguesit: numri i personave në rrezik, të cilët përfitojnë nga shërbimet; koha mesatare e pritjes përpara pranimit në programet e ndihmës				
3.(b).1	Të sigurohen vlerësime të vazhdueshme të situatës në nivel rajonal, të evidentohen grupet në nevojë, si dhe të bëhet një vlerësim i shërbimeve aktuale me ato të nevojshme dhe të sigurohet ekzistenca e këtyre shërbimeve.	KRAT, bashkitë/komunat, ZKKA me mbështetjen e partnerëve	Në vazhdimësi	Ekzistenca e vlerësimeve të situatës në bazë në nivel qarku. Ekzistenca e vlerësimeve periodike të situatës. Evidenca të veprimeve të ndërmarra për të siguruar disponueshmërinë e shërbimeve.	Ekzistuese
3.(b).2	Të hartohen programe dhe masa specifike parandaluese në nivel qendror dhe vendor për	KRAT, bashkitë/komunat, ZKKA me partnerët	Në vazhdimësi	Ekzistenca e programeve vjetorë të parandalimit (si pjesë e programimit të PKV për	Ekzistuese

⁵ Shih gjithashtu kapitullin për mbrojtjen.

⁶ Shih kapitullin për mbrojtjen.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	grupet/komunat në nevojë dhe të monitorohet zbatimi i veprimtarive në nivel vendor (si pjesë e planit të monitorimit) ⁷			antitrafikimin). Ekzistenca e raporteve periodikë monitorues.	
3.(b).3	Të lehtësohet sigurimi i shërbimeve sociale (ndihma sociale, strehimi, shërbimet shëndetësore, arsimi, trajnimi profesional, punësimi etj.) për grupet në nevojë dhe personat në rrezik trafikimi: - Të lëshohen e të zbatohen udhëzimet për të gjitha subjektet që sigurojnë ndihmë sociale që këto të fundit t'u japin përparësi personave në rrezik. - Skemat t'u shpërndahen të gjitha grupeve në nevojë.	Ministritë e linjës (sidomos MASH, MPÇSSHB, MSH, MPPTT) nëpërmjet zyrave të tyre rajonale, KRAT në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i personave të identifikuar në rrezik të cilët përfitojnë nga këto shërbime. Ekzistenca e udhëzimeve. Numri dhe përqindja e grupeve në rrezik të lartë të cilët janë të informuar për ndihmën dhe shërbimet që janë të disponueshme për ta.	Ekzistuese
3.(b).4	Të vazhdojë sensibilizimi i të gjitha subjekteve shtetëror të përfshira në çështjet e antitrafikimit (arsimi, policia, subjektet vendore të shërbimit shëndetësor, inspektorët e punës dhe personeli i zyrave të punës, punonjësit socialë, njësitë e barazisë gjinore dhe dhunës në familje etj.) dhe të sigurohet që çështjet e antitrafikimit të përfshihen në veprimtaritë e tyre të rregullta (si pjesë e termave të referencës)	Ministritë e linjës, ZKKA, KRAT, bashkitë/komunat.	Në vazhdimësi	Termat e referencës të përfshijnë asistencë për personat e trafikuar dhe grupet në rrezik. Përqindja e zyrtarëve përkatës, të cilët janë të njohur me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe masave që duhen marrë.	Ekzistuese
3.(b).6	Të sigurohen shërbimet e ndërhyrjes në rast krizash, si dhe shërbimet afatgjata të mbështetjes për personat në krizë (ku përfshihen: dhuna në familje, përkrahja sociale, abuzimi i fëmijëve)	Bashkitë/komunat (zyrat e asistencës dhe njësitë e mbrojtjes sociale), MPÇSSHB, KRAT, ZKKA dhe shoqëria civile	Në vazhdimësi	Numri i rasteve të asistuar.	Ekzistuese
4	SYNIMI STRATEGJIK: Të parandalohet trafikimi i qenieve njerëzore dhe të ndërpriten situatat aktuale shfrytëzuese të trafikimit nëpërmjet masave administrative.				
	Tregues: Numri i rasteve apo krimeve të lidhura me trafikimin të zbuluara nëpërmjet kontrolleve administrative.				
4.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të sigurohet rregullimi dhe monitorimi i të gjithë sektorëve të shoqërisë që mund të preken nga trafikimi.				
	Treguesit: Reduktimi në përqindje i viktimave të trafikimit të cilët raportojnë se janë rekrutuar nëpërmjet agjencive private të punësimit, agjencive turistike e të udhëtimeve, agjencive të martesave dhe adoptimeve.				
4.(a).1	Të rritet roli i agjencive private të punësimit <i>bona fide</i> . Të botohet në faqen e internetit të MPÇSSHB, Kodi i Etikës dhe në faqen e internetit të forumit të agjencive private të punësimit të botohen të gjitha agjencitë e licencuara private të punësimit.	Forumi i Agjencive Private të Punësimit	Brenda 2011	Të jenë botuar Kodet e Etikës, si dhe lista e agjencive private të punësimit. Të publikohet puna e agjencive private të punësimit. Të jetë trajnuar personeli i agjencive private të punësimit. Numri i vendeve të punës të gjetura nga agjencitë private të punësimit në përgjithësi, dhe në veçanti për personat në nevojë.	Ekzistuese
4.(a).2	Të monitorohet zbatimi i Kodit ekzistues të Etikës për Turizmin.	MTKRS, Policia e Shtetit, ZKKA, OSBE, agjencitë turistike, hotele/motele, operatorët turistikë nënshkruar të Kodit	Në vazhdimësi	Raporte periodike monitoruese. Numri i rasteve të raportuara të mosrespektimit dhe masat e marra.	Ekzistuese
4.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të krijohen sisteme monitoruese shumëdisiplinore për sektorët në nevojë dhe ekonominë informale shfrytëzuese dhe të sigurohet gjithashtu zbatimi i të drejtave ekzistuese të punës dhe standardeve të tregut të punës.				
	Treguesit: Numri i rasteve të zbuluar dhe numri i ndjekjeve bazuar në informacionet e mbledhura dhe kontrollet e punës; përqindja e ndërmarrjeve që kontrollohen (çdo vit) nga Inspektorati i Punës.				
4.(b).1	Të monitorohet ekonomia informale me qëllim identifikimin e personave në rrezik trafikimi dhe/ose të shfrytëzuar për punë të detyruar.	MPÇSSHB, MF, MB Inspektorati i Përgjithshëm i Punës, Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me shoqërinë civile.	Në vazhdimësi	Inspektorati i Punës kryen inspektime periodike dhe "surprizë" për të identifikuar persona të shfrytëzuar për punë.	Ekzistuese
4.(b).2	Të forcohet kapaciteti i zyrave të inspektoratit të punës për të siguruar zbatimin e standardeve	MPÇSSHB (Inspektorati i Përgjithshëm i Punës)	Brenda 2011	Përqindja e ndërmarrjeve të kontrolluara (çdo vit) nga Inspektorati i Punës.	Ekzistuese

⁷ Shih gjithashtu kapitullin për bashkërendimin.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burime
	të tregut të punës, si dhe për të zbuluar rastet e shfrytëzimit të punës dhe të trafikimit: - Trajnimi i inspektorateve rajonale të punës, si dhe inspektorëve vendorë për inspektimin e punës, trafikimin e qenieve njerëzore dhe evidentimin e rasteve në rrezik apo rasteve të trafikimit.			Të jenë trajnuar inspektoratet e punës në nivel rajonal dhe vendor.	
4.(c)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të forcohet aftësia për të zbuluar dhe parandaluar rastet e mundshme të trafikimit në nivel parakufitar (konsullor) dhe të rriten rastet e identifikimit të viktimave potenciale në pikat kufitare.				
	Treguesit: Numri i refuzimit të dhënies së vizave për dyshim trafikimi; numri i personave të trafikuar apo personave në rrezik të evidentuar në kufi.				
4.(c).1	Të trajnohen punonjësit e konsullatave, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të evidentojnë emigrantët, të cilët mund të jenë në rrezik dhe të japin informacion pa shkelur të drejtat e njeriut, apo të tërheqin vizat e tyre për dyshim trafikimi.	MPJ, ZKKA me partnerët	Në vazhdimësi	Numri i trajnimeve të organizuara. Numri i personave të trajnuar. Të ketë udhëzime të shkruara. Të përgatiten broshura informative. Numri i broshurave që u është shpërndarë emigrantëve në rrezik.	Ekzistuese
4.(c).2	Të trajnohen rojet kufitare, në kuadër edhe të liberalizimit të lëvizjes së lirë, për identifikimin e rasteve në rrezik dhe të japin informacion pa shkelur të drejtat e njeriut.	MB, Policia e Shtetit, Qendra e Formimit Policor	Brenda 2011	Trajnimet e organizuara. Numri i personave të trajnuar materiale informuese të shpërndara. Numri i broshurave të shpërndara.	Ekzistuese
4.(d)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të zbatohen kërkesat për regjistrimin e gjendjes civile (dokumentacioni ligjor për lindjen, shtetësinë dhe martesën) për të lehtësuar përfshirjen sociale dhe aksesin në arsim dhe shërbime të tjera sociale				
	Treguesit: Përqindja e popullsisë së regjistruar dhe që ka dokumentacion të ligjshëm identifikues				
4.(d).1	Të përmirësohet regjistrimi i lindjeve me anë të kombinimit të sistemeve nxitëse; duke siguruar regjistrim falas për familje me të ardhura të ulëta; duke përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të shëndetësisë dhe Zyrës së Gjendjes Civile dhe OJF-ve të komunitetit rom.	MB, MSH, BKTF, OJF që mbrojnë interesat e komunitetit rom	Në vazhdimësi	Synimi: Rritja e regjistrimit të lindjeve në numër dhe në përqindje.	Ekzistuese
4.(d).2	Sensibilizimi i stafit të shërbimit konsullor për regjistrimin e lindjeve në ambasadat jashtë shtetit.	MPJ	Në vazhdimësi	Numri i materialeve sensibilizuese/numri i udhëzime Synimi: Rritja e regjistrimit të lindjeve në numër dhe e certifikatave të lindjes të lëshuara jashtë vendit.	Ekzistuese

IV. BASHKËRENDIMI

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati kohor	Treguesit/synimet	Burime
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Përmirësimi i bashkërendimit të të gjitha masave kundër trafikimit dhe bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në fushën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri.				
	Treguesit: perceptimi i efektivitetit të bashkëpunimit sipas të gjithë aktorëve të përfshirë; bashkëpunim i kënaqshëm ndërmjet aktorëve të përfshirë.				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Të sigurohet një vështrim i përgjithshëm i vazhdueshëm i të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të njerëzve, si dhe i projekteve/ masave të zbatuara në vend dhe të inkurajohet shkëmbimi i informacionit ndërmjet organizatave partnere, organizatave shtetërore dhe joshetërore.				
	Treguesit: listë e përditësuar e aktorëve të përfshirë në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit, si dhe e projekteve antitrafikim				
1.(a).1	Të mbahet një listë e përditësuar e aktorëve dhe veprimtarive	ZKKA	Në vazhdim	Ekzistenca e një liste rregullisht të përditësuar të OJF-ve, institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe listës së projekteve/masave të zbatuara në fushën e antitrafikimit. Faqja e internetit të ZKKA-së të përditësohet rregullisht	Ekzistuese
1.(a).2.	Të sigurohet shkëmbim i rregullt informacioni ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës me anë të takimeve të rregullta, një faqeje interneti, si dhe me anë të një buletini.	ZKKA	Në vazhdim	Faqja e internetit të ZKKA-së të përditësohet rregullisht Mbajtja e takimeve periodike me task forcën kombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore, organizatat ndërkombëtare, donatorët etj. Ekzistenca e raporteve gjashtëmujorë mbi situatën dhe veprimtaritë përkatëse.	Ekzistuese
1.(a).3	Të gjitha strukturat zbatuese t'i raportojnë rregullisht (çdo 3 muaj) ZKKA-së mbi veprimtaritë e tyre dhe planet e punës për 6-mujorin e ardhshëm të vitit.	Të gjitha strukturat zbatuese	Në vazhdim	Ekzistenca e raporteve gjashtëmujorë nga të gjitha strukturat zbatuese. Konsolidimi i planeve të punës dhe veprimtarive. Ekzistenca e një liste të përditësuar .	Ekzistuese
1.(a).4	Mbajtja e takimeve periodike (çdo tre muaj) me organizatat ndërkombëtare, strukturat dhe donatorët.	ZKKA	Në vazhdim	Bashkërendim më i mirë dhe mbështetje për zbatimin e PKV-së.	Ekzistuese
1.(a).5	Monitorimi i pandërprerë i hapësirës detare dhe shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera që kanë interesa në det.	FD, QNOD (kapitaneritë e porteve, Policia Kufitare, Inspektorati i peshkimit, autoritetet doganore, Antikontrabanda Detare etj.)	Në vazhdim	Përgatitja e raporteve ditore, mujore, tremujore dhe vjetore lidhur me monitorimin e situatës së hapësirës detare të RSH-së.	MM
1(a).6	Zbatim i vendimit të Këshillit të Ministrave "Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore që kanë interesa në det". Shkëmbimi i informacionit me Qendrën Operacionale në Romë në zbatim të marrëveshjes V-RMTC.	MM (QNOD, FD), MB (DKM), MF (doganat), Forcat Detare	Në vazhdim	Funksionimi i sistemit të integruar të hapësirës detare të RSH-së.	MM
1.(a).7	Zbatim i planeve të bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit nëpërmjet shërbimeve inteligjente.	Shërbimet inteligjente të FD, SHIU, PU, Policia kriminale etj.	6-mujori i dytë i 2011	Hartimi, miratimi dhe zbatim i planeve të bashkëpunimit.	MM
1.(a).8	Stërvitje të përbashkëta (rajonale dhe bilaterale – iniciativa ADRION) me vendet partnere, si edhe me institucionet e tjera që kanë interesa në det.	FD, Forcat Ajrore, PKM	Çdo vit	Numri i stërvitjeve të përbashkëta	MM dhe ekzistuese
1.(a).9	Pjesëmarrje në operacionin "ACTIVE ENDEAVOUR"	FD (QNOD)	Sipas marrëveshjes	Shkëmbimi i përditshëm i informacionit me Komandën e Komponentit Detar të NATO-s në Napoli	MM dhe ekzistuese
1.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Institucionalizimi i një kuadri kombëtar funksional për bashkëpunimin dhe bashkërendimin për çështjet kundër trafikimit (në të cilin të përfshihet një mekanizëm për bashkërendimin, përcaktimin e politikave, monitorimin dhe rishikimin e reagimit antitrafikim nga njëra anë dhe mekanizmi kombëtar i referimit për trajtimin e rasteve individuale nga ana tjetër) dhe të sigurohet funksionimi i plotë i tij, duke qartësuar dhe				

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati kohor	Treguesit/synimet	Burime
	detajuar rolet, përgjegjësitë përkatëse dhe ndarjen e detyrave ndërmjet aktorëve kombëtarë, rajonalë dhe lokalë dhe duke forcuar kapacitetin e aktorëve të përfshirë.				
	Tregues: Termat e referencës për të gjithë aktorët. Ekzistenca e PSO-ve për bashkëpunim dhe bashkërendim.				
1.(b).1.1	Të sigurohet miratimi i Planit të Veprimit nga Komiteti Shtetëror për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. [shih II Mbrojtja 1(a). 1.1.]	ZKKA	Fillimi i 2011	Miratimi i planit të veprimit	Ekzistuese (të çdo institucioni të përfshirë) dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).1.2	Seminare trajnuese me të gjithë komitetet rajonale antitrafikimit.	ZKKA,	Në vazhdim	Të gjithë komitetet rajonale për antitrafikimin dhe tryezat teknike të jenë trajnuar dhe të jenë të njohur me strukturën e parashikuar dhe detyrat e tyre përkatëse.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).1.4	Të zbatohen ndryshimet e parashikuara: rishikimi i marrëveshjes së MKR-së; urdhri i përbashkët për krijimin e AP, urdhri i Kryeministrit për krijimin e komiteteve rajonale për antitrafikimin etj.	ZKKA me grupin e ekspertëve dhe organizatat këshilluese	6-mujori i dytë i 2011	Ekzistenca e marrëveshjeve, urdhrave të rishikuar etj.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).1.5	Të konsolidohen mandatat dhe termat e referencës të të gjithë aktorëve të përfshirë në përputhje me PSV-të.	ZKKA me grupin e ekspertëve dhe organizatat këshilluese	6-mujori i dytë i 2011	Mandatet dhe termat e referencës të jenë të rishikuar për të gjithë aktorët.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).2	Të përforcohet menjëherë Zyra e Koordinatorit Kombëtar për të bërë të mundur zbatimin e veprimtarive të parashikuara në planin kombëtar të veprimit.	MB, Këshilli i Ministrave	6-mujori i dytë i 2011	Ekzistenca e manualit/udhëzuesit për funksionimin e ZKKA-së. Të jetë rritur kapaciteti i stafit të ZKKA-së ku të jenë të paktën 7 persona gjithsej; Ekzistenca e një infrastrukture të përshtatshme të zyrave dhe mjediseve për personelin e ZKKA-së, si dhe për zyrën bërthamë (me tre persona) të autoritetit përgjegjës (shih më poshtë). Të zbatohet PKV.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).3	Të forcohet kapaciteti i autoritetit përgjegjës për përbushjen e përgjegjësisë së tij.	ZKKA, palët nënshkruese të MKR-së, AP.	6-mujori i dytë i 2011	Të jetë krijuar zyra bërthamë me tre punonjës të përhershëm, bashkëngjitur ZKKA-së. Një pjesë e kohës së punonjësve (të paktën 25%) t'u caktohet pikave të kontaktit të AP të miratuar nga ministritë e linjës (oraret e punës të punonjësve).	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).3.2	Të krijohet ekipi bërthamë me tre punonjës me kohë të plotë, i cili do t'i bashkëngjitet dhe do të jetë nën mbikëqyrjen e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar (ZKKA), si dhe të institucionalizohen takimet me të gjitha pikat e kontaktit të AP-së.	Këshilli i Ministrave, Komiteti Shtetëror, MB, ZKKA.	6-mujori i dytë i 2011	Të jetë krijuar zyra bërthamë me tre punonjës të përhershëm, bashkëngjitur ZKKA-së. Një pjesë e kohës së punonjësve (të paktën 25%) t'u caktohet pikave të kontaktit të AP të miratuar nga ministritë e linjës (oraret e punës të punonjësve).	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).3.3	Të përgatitet krijimi i një zyre të veçantë për autoritetin përgjegjës deri në vitin 2011.	Këshilli i Ministrave, Komiteti Shtetëror, MB, ZKKA.	6-mujori i dytë i 2011	Të ekzistojë një Zyrë e veçantë e Autoritetit Përgjegjës me të paktën 8 persona (pikat e kontaktit të AP i caktohen AP-së me kohë të plotë ku shtohet edhe një koordinator).	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).4	Të vazhdojë funksionimi i Task Forcës Kombëtare për Trafikimin e Qenieve Njerëzore.	Komiteti Shtetëror, ZKKA, me të gjithë aktorët përkatës shtetëror dhe joshetëror	Në vazhdim	Të mbahen takime periodike.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).4.1	Të organizohet një seminar për të njohur Task Forcën Kombëtare për Trafikimin e Njerëzve me strategjinë e re antitrafikimit dhe planin e veprimit 2010-2013.	ZKKA, Komiteti Shtetëror	6-mujori i dytë i 2011		Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(b).5	Rishikim i urdhrat të Kryeministrit për ngritjen e komiteteve rajonale të antitrafikimit; ngritja e termave të referencës, duke zgjeruar anëtarësinë e komiteteve rajonale për të përfshirë anëtarë të Këshillit të Qarkut, Nënprefekti, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Drejtorinë Rajonale e Kufirit	Grupi i ekspertëve me ZKKA dhe partnerë ndërkombëtarë	6-mujori i dytë i 2011	Urdhri i Kryeministrit i rishikuar zgjeruar për të përfshirë këshillat e qarkut, nënprefektin, Kryetarin e Këshillit të Qarkut, Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit dhe OJF dhe emërimi i një koordinatori me kohë të plotë në nivel teknik për	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati kohor	Treguesit/synimet	Burime
	dhe Migracionit, si dhe organizata joqeveritare.			tryeza teknike. Ekzistenca e termave të referencës për komitetet rajonale dhe tryeza teknike.	
1.(b).5.2	Trajnime/seminare me komitetet rajonale për të hartuar plane pune të KRAT dhe tryeza teknike në linjë me termat e rinj të referencës.	ZKKA, KRAT, anëtarë të grupit të ekspertëve dhe partnerë të tjerë, OSBE etj.	Në vazhdim	Anëtarë të KRAT dhe TT të strukturave kombëtare dhe roli i tyre dhe TR. Ekzistenca e planeve të punës për KRAT dhe tryezat teknike. Mbajtja e takimeve periodike.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(c).	OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi mbarëkombëtar i njohjes së strategjisë dhe plan veprimit kombëtar dhe që rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të kuptohen qartë dhe të zbatohen				
	Tregues: Përqindja e aktorëve përkatës që njohin strategjinë dhe detyrat e tyre përkatëse; përqindja e veprimtarive të zbatuara në përputhje me planin kombëtar të veprimit				
1.(c).1	Promovimi i strategjisë dhe planit kombëtar të veprimit në mbarë vendin duke shpërndarë kopje të strategjisë dhe PKV	ZKKA	6-mujori i dytë i 2011	Strategjia e shpërndarë dhe e disponueshme në të gjitha qarqet dhe bashkitë dhe në të gjitha ministrinë e linjës, komitetet rajonale, zgjedhësit etj.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(c).1.1	Organizimi i seminareve/takimeve për të informuar aktorët kryesorë rreth strategjisë dhe për të diskutuar/qartësuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse me: - Task Forcën Kombëtare për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (shih më lart). - Komitetet rajonale (si pjesë e seminareve të trajnimit). - Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët. - Organizimi i seminareve/takimeve në nivel bashkie/komune. - Përfaqësues të qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare në nivel bashkie/komune.	ZKKA, KRAT	6-mujori i dytë i 2011	Seminare të mbajtura me Task Forcën Kombëtare për TQNJ (shih më lart). Seminar i mbajtur me të gjitha KRAT. Takime periodike të mbajtura me të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(c).2	Monitorimi dhe zbatimimi i strategjisë sipas planit të monitorimit (shih më poshtë)	ZKKA me të gjithë aktorët	Në vazhdim	Ekzistenca e raporteve periodike të monitorimit	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
1.(c).2.1	Mbledhja e takimeve periodike (të rregullta) të Task Forcës Kombëtare për TQNJ, organizatave ndërkombëtare, agjencive dhe donatorëve (dy herë në vit), si dhe Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (dy herë në vit) për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të PKV dhe për të ndërmarrë veprime rregullatore sipas nevojës.	Komiteti Shtetëror, Taks Forca Kombëtare, ZKKA me të gjithë aktorët	Në vazhdim	Mbajtja e takimeve periodike të Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit (dy herë në vit) dhe të Task Forcës Kombëtare për TQNJ (çdo tre muaj) Procesverbale të takimeve	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
2.	SYNIMI STRATEGJIK: Të sigurohet që i gjithë informacioni dhe të dhënat në lidhje me luftën kundër trafikimit njerëzor të jenë të disponueshme, të arritshme nga të gjithë aktorët e përfshirë dhe që të shkëmbehen rregullisht si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar				
	Tregues: Përqindja e të dhënave kyçe për të cilat janë të disponueshme të dhëna të plota reale, ekzistenca e raporteve periodike me të dhëna kyçe; ekzistenca e raporteve periodike të gjendjes së situatës/vlerësimit				
2.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ngritja e mekanizmave për shkëmbimin e informacionit në përputhje me përkufizimet e caktuara dhe për të dhënat kyçe të përcaktuara				
	Tregues: miratimi i përkufizimeve të përbashkëta standarde				
2.(a).1	Përcaktimi i përkufizimeve të përbashkëta për shifrat/kategoritë statistikore kryesore të përputhshme edhe në nivel ndërkombëtar mbi trafikimin për t'u monitoruar në nivel kombëtar dhe rajonal [Shih Mbrojtja 1(b).4]	ZKKA, KRAT, BKTF, MD, ILO, IOM, ICMPD, OSBE, UNODC, UNICEF etj., me këshillim ekspert nga donatorët	Deri në 2012	Grup pune i posaçëm i ngritur. Ekziston listë me përkufizime të përbashkëta dhe shifra/kategori statistikore kryesore (përfshirja e viktimave të mundshme/potenciale/të identifikuara, grupet dhe individët në rrezik dhe vulnerabël) dhe e adoptuar nga të gjithë aktorët e antitrafikimit, përmes Task Forcës Kombëtare për TQNJ.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
2.(a).1.2	Forcimi i kapacitetit të ZKKA-së dhe KRAT-ve për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë të gjithë informacionin	ZKKA, KRAT, MB, MPJ	Në vazhdim	Vendosja e personelit, pajisjeve dhe ekspertizës së teknologjisë së informacionit, aftësi analitike.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
2.(a).1.3	Institucionalizimi i shkëmbimit të informacionit mes të gjithë aktorëve, sipas modaliteteve dhe modeleve të paracaktuara	ZKKA, komitetet rajonale antitrafikim, të gjithë aktorët e përfshirë	Në vazhdim	Ekzistenca e modaliteteve të paracaktuara për shkëmbimin e informacionit.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati kohor	Treguesit/synimet	Burime
	[Shih Mbrojtja 2(a)1.3]			Ekzistenca e raporteve.	
2.(a).1.4	Zhvillimi i vlerësimeve periodike të situatës së trafikimit në të gjitha qarqet (shih gjithashtu më poshtë)	Komitetet rajonale të antitrafikimit në bashkëpunim me bashkitë, komunat, ZKKA, ministritë e linjës, OJF, organizatat ndërkombëtare dhe me mbështetjen e partnerëve të tjerë.	Në vazhdim	Ekzistenca e vlerësimeve të situatës për çdo qark si bazë për rishikime të mëvonshme. Ekzistenca e raporteve periodike të vlerësimeve të situatës (dy herë në vit).	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
2.(a).1.5	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit në nivel ndërkombëtar (veçanërisht me Greqinë, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe fqinjët e afërt)	ZKKA, MB, PSH, MD, MPJ, PP	Në vazhdim	Zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese dhe të reja për shkëmbimin e informacionit	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
2.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritje e kërkimeve kombëtare rreth trafikimit të qenieve njerëzore				
	Synimi/tregues: Rritja e vëllimit total financiar të projekteve kërkimore rreth trafikimit njerëzor, përqindja e buxhetit kombëtar për kërkimet të shpenzuar për kërkimet e lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore				
2.(b).2	Rritja e kërkimeve kombëtare rreth çështjeve parësore si shkaqet rrënjësore të trafikimit, trafikimit për punë të detyruar etj., si edhe kërkimi (profilizimi i klientëve të personave të trafikuar) dhe profilizimi i trafikantëve	ZKKA, Task Forca Kombëtare për TQNJ, dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë	Në vazhdim	Përpjesëtim të identifikuar pas vlerësimeve të situatës. Ekzistenca e studimeve rreth temave parësore të identifikuar përfshi kërkesat, shfrytëzimi për punë, trafikimi i brendshëm, profili i trafikantit.	Ekzistuese në bashkëpunim me donatorë
3	SYNIMI STRATEGJIK: Të sigurohen të gjitha burimet e nevojshme për zbatimin e strategjisë kombëtare të antitrafikimit dhe PKV, dhe të rritet pjesa e financuar nga qeveria e financimit të përgjithshëm të strategjisë/PKV				
3.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ngritja e një skeme për buxhetin, raportimin dhe kontrollin dhe rritja e vëllimeve të përgjithshme financiare të disponueshme për zbatimin e PKV-së				
	Tregues: hartimi i planeve buxhetore për zbatimin e aktiviteteve, përfshirja në PBA				
3.(a).1	Futja dhe zbatimi i skemës për raportimin dhe kontrollin financiar për të gjithë aktorët në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar	Të gjitha agjencitë përgjegjëse, ZKKA	Në vazhdim	Të gjitha ministritë dhe aktorët e tjerë ofrojnë plane buxheti vjetore dhe raporte vjetore të shpenzimeve. Ekzistenca e planeve vjetore për burimet dhe e raporteve të shpenzimeve.	Ekzistues (të çdo institucioni të përfshirë)
3.(a).1.2	Të gjithë aktorët përgatitin plane pune dhe buxhete individuale (në bazë vjetore) për zbatimin e strategjisë.	Të gjithë aktorët	Në vazhdim	Ekzistenca e planeve të punës me planin rezervë të secilit prej aktorëve të përfshirë në zbatimin e PKV-së	Ekzistues (të çdo institucioni të përfshirë)
3.(a).1.3	Të gjithë aktorët i paraqesin ZKKA-së në fund të vitit raporte për shpenzimet vjetore për zbatimin e detyrave të tyre në PKV në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga ZKKA-ja	Të gjithë aktorët	Çdo fund viti	Ekzistenca e raporteve të shpenzimeve	Ekzistues (të çdo institucioni të përfshirë)
3.(a).1.4	Përpilimi në fund të vitit i raporteve të shpenzimeve për zbatimin e PKV-së	ZKKA, me kontribut nga të gjithë aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë	Çdo fund viti	Ekzistenca e raportit të shpenzimeve.	Ekzistuese
3.(a).2	Zhvillimi i takimeve periodike (tremujore) agjencitë, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare për të paraqitur përparësitë e qeverisë shqiptare dhe për të bashkërenduar veprimtaritë me planet e ndihmës së donatorëve/organizatave	ZKKA	Në vazhdim	Organizimi i takimeve periodike. Ekzistenca e procesverbaleve Përmirësimi i bashkërendimit sjell si rezultat rritjen e financimit dhe mbështetjes së donatorëve për zbatimin e strategjisë/PKV-së së qeverisë shqiptare.	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
4	SYNIMI STRATEGJIK: Përmirësimi i vazhdueshëm i masave antitrafikim në nivel strategjik dhe operativ, si dhe përshtatja e tyre me kërkesat e reja dhe rrethanat e ndryshuara duke krijuar/forcuar një sistem për rishikimin, monitorimin dhe vlerësimin sistematik të strategjisë dhe PKV-së kundër trafikimit.				
	Tregues: Zotërimi i një strategjie dhe PKV-je antitrafikim të përditësuar deri në fund të vitit 2013; ekzistenca e një raporti afatmesëm ecurie me ndryshime afatshkurtra në PKV, nëse është e nevojshme.				
4.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i rishikimit të reagimit antitrafikim në intervale periodike, nën përgjegjësinë e koordinatorit kombëtar				
	Treguesit: ekzistenca e termave të referencës për rishikimin, ekzistenca e rishikimit me shkrim të strategjisë/PKV-së, ekzistenca e vlerësimeve të situatës				
4.(a).1.1	Kryerja e vlerësimeve fillestare të situatës në të gjitha qarqet, si bazë për rishikimin e ardhshëm të strategjisë/PKV-së; vlerësime vijuese në intervale periodike	Komitetet rajonale antitrafikim në bashkëpunim me bashkitë, komunat, ZKKA-në, OJF-të, ON-të dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve.	6-mujori i parë i 2011	Ekzistenca e vlerësimeve të situatës për çdo qark, si bazë për rishikimet e ardhshme. Ekzistenca e raporteve sistematike të vlerësimit të situatës (dy herë në vit).	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve.
4.(a).2	Kryerja e rishikimit të strategjisë dhe PKV-së, bazuar mbi monitorimin dhe vlerësimin (shih më poshtë)	ZKKA, Task Forca Kombëtare për Antitrafikim, me mbështetjen e ekspertëve	Fundi i 2012	Ekzistenca e rishikimeve me shkrim	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afati kohor	Treguesit/synimet	Burime
		të jashtëm, si dhe me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë			
4.(a).3	Diskutimi dhe miratimi i rezultateve dhe rekomandimeve nga grupi i Task Forcës për Antitrafikimin. Hartimi dhe miratimi i strategjisë/PKV-së së re nga Komiteti Shtetëror/ Qeveria	ZKKA, Task Forca Kombëtare për Antitrafikimin, Komiteti Shtetëror	Fundi i 2012	Ekzistenca e strategjisë/PKV-së së re dhe miratimi nga Task Forca si edhe Komiteti Shtetëror	Ekzistuese
4.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i mbledhjes dhe analizimit të vazhdueshëm e sistematik të gjithë informacionit dhe të dhënave në nivel operativ e strategjik, duke krijuar një sistem monitorimi, si për qëllim vetëvlerësimi e rishikimi, ashtu edhe për qëllime raportimi				
	Synimi: Ekzistenca e termave të referencës dhe planit të monitorimit; ekzistenca e raporteve sistematike të monitorimit; si edhe raporte ecurie afatmesme;				
4.(b).3	Vendosja e një raportimi të detyrueshëm në bazë tremujore, në përputhje me modelin e monitorimit të të gjitha veprimtarive/masave të zbatuara nga të gjithë aktorët	ZKKA me Task Forcën Kombëtare për Antitrafikimin	Çdo tre muaj	Njohja e të gjithë aktorëve me planin e monitorimit dhe kërkesat e raportimit dhe veprimi në përputhje me to	Ekzistuese
4.(b).4	Donatorët ndërkombëtarë do të përfshijnë në marrëveshjet e tyre të grantit kërkesat e raportimit të ZKKA-ja, në përputhje me planin e monitorimit	Donatorët ndërkombëtarë	Në vazhdim	Të gjithë grantmarrësit i raportojnë ZKKA-së, sipas një plani dhe modeli të pranuar monitorimi	
4.(b).5	Nxjerrja e raporteve sistematike monitorimi dhe zhvillimi i takimeve sistematike me të gjithë aktorët për diskutimin e ecurisë së zbatimit dhe rënien dakord mbi masat dhe ndryshimet afatshkurtra të PKV-së, nëse është e nevojshme:	ZKKA	Në vazhdim	Ekzistenca e raporteve sistematike të monitorimit	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
4.(b).5.1	Organizimi i takimeve periodike (tremujore) të Task Forcës Kombëtare për Antitrafikimit dhe me partnerët ndërkombëtarë dhe i takimeve periodike (vjetore) të Komitetit Shtetëror Antitrafikim	ZKKA me Task Forcën Kombëtare dhe me Komitetin Shtetëror	Çdo tre muaj	Takime sistematike të Task Forcës Kombëtare për Antitrafikimin (tremujore) dhe të Komitetit Shtetëror (vjetore). Procesverbale të takimeve	Ekzistuese dhe me mbështetjen e donatorëve/partnerëve
4.(b).5.2	Përpunimi i raporteve afatmesme të ecurisë, përfshi sugjerimet për ndryshime afatshkurtra në PKV dhe diskutimi i tyre me Task Forcën Kombëtare	ZKKA	Në vazhdim	Ekzistenca e raporteve afatmesme të ecurisë, miratuar nga Komiteti Shtetëror kundër Trafikimit	Ekzistuese
4.(c)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i vlerësimit sistematik të të gjitha veprimtarive të parashikuara në PKV				
	Synimi: ekzistenca e raporteve të vlerësimit me shkrim për të paktën 50 për qind të veprimtarive të parashikuara në kuadër të PKV-së				
4.(c).2	Përfshirja e kërkesave të vlerësimit për të gjithë aktorët dhe masat e parashikuara në PKV	ZKKA me Task Forcën Kombëtare të Antitrafikimit	6-mujori i dytë i 2011	Njohja nga të gjithë aktorët e kërkesave të vlerësimit dhe veprimi në përputhje me to Ekzistenca e raporteve të vlerësimit	Ekzistuese

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT

PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

I. NDJEKJA PENALE

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Rritja e numrit të ndjekjeve penale të suksesshme dhe evidentimi i rasteve të reja të trafikimit të brendshëm dhe transnacional për të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve në veçanti atij për punë dhe për lypje, si dhe sigurimi i procedimeve penale që janë të përshtatshme dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke garantuar të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijës.				
	Treguesit/synimet: Numri i ndjekjeve penale dhe dënimeve për trafikimin e fëmijëve; numri i viktimave që denoncojnë trajtime diskriminuese; numri i rasteve të trafikimit të brendshëm të fëmijëve.				
1.(a)	OBJEKTIV SPECIFIK: Sigurimi i zbatimit të standardeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe akteve të tjera ligjore në fuqi për përfshirjen e fëmijëve në procedurat penale				
	Treguesit: Numri i zyrtarëve (oficerë të policë, prokurorë, gjyqtarë) që njohin standardet e trajtimit të fëmijëve të trafikuar në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe mund të përshkruajnë komponentët kryesorë të një trajtimi të tillë të ndjeshëm ndaj fëmijëve;				
1.(a).1.	Zbatimi i standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e viktimave fëmijë gjatë procedimeve penale, në kuadrin e MKR-së.	Anëtarët e MKR-së, AP, KKSAT, ZKKA, DPPSH, PP, Avokati i Popullit, si edhe OJF-të dhe ON-të (IOM, WV, BKTF, UNICEF etj.)	Në vazhdimësi	Zbatimi i PSV-ve për identifikimin dhe referimin e viktimave fëmijë, përfshi trajtimin gjatë procedimeve penale	Ekzistuese
1(a).2	Përmirësimi i kuadrin ligjor penal në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimi, abuzimi dhe keqtrajtimi, si dhe forcimi i kapaciteteve hetimore në këtë drejtim.	MB – PSH, MD, PP në bashkëpunim me ON dhe OJF	2012	Rritja e numrit të ndjekjeve penale për rastet e trafikimit, shfrytëzimit, abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve.	Ekzistuese
1(a).2.1.	Kryerja e një studimi të legjislacionit të brendshëm penal që rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi.	MD, MB, në bashkëpunim me PP dhe Gjykatat, BKTF, World Vision, si dhe me mbështetjen dhe konsultimin e OJF dhe ON të specializuara në këtë fushë.	2011	Identifikimi i mangësive ligjore dhe ndërmarrja e iniciativës për përmirësimin e kuadrin të brendshëm ligjor	Ekzistuese
1.(a).3	Nxjerrja e udhëzimeve për intervistimin dhe mbledhjen e të dhënave nga viktimat fëmijë, me qëllim garantimin e standardeve, si marrja në pyetje e fëmijës në praninë e kujdestarit ligjor, sigurimin e ndihmës nga punonjësit socialë, oficeri i policisë dhe eksperti, si dhe kryerja e të gjitha veprimeve të orientuara në interesin më të lartë të fëmijës.	Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike - MD, anëtarët e MKR-së, KKSAT, si edhe OJF-të dhe ON-të (BKTF, UNICEF, ICPMD etj.)	2011	Ekzistenca e direktivave (standarde dhe procedura) për intervistimin dhe mbledhjen e provave nga viktimat fëmijë, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe qartësimi i rolit të kujdestarit ligjor të fëmijës, si dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në proces. Dëshmia e fëmijës regjistrohet për të garantuar kriteret e cilësisë së provës në mënyrë që të shmanget edhe përsëritja e dëshmisë nga fëmija.	Ekzistuese
1.(a).4	Sigurimi i ndihmës dhe këshillimit ligjor të fëmijës nga një jurist dhe kujdestar ligjor paralelisht me ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga punonjësi social.	Prokuroria e Përgjithshme, Policia e Shtetit, MPÇSSHB, Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike - MD, ON dhe OJF si UNICEF, TdH, CAFOD, ILO, Qendra për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare etj.	Në vazhdimësi	Numri i viktimave të mitura të trafikimit, të cilët kanë marrë ndihmë ligjore; Numri i ankesave të fëmijëve apo kujdestarit të tyre ligjor për mungesën e ndihmës juridike	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
1.(a).5	Kryerja e trajnimeve sistematike të specializuara për policinë, gjyqtarët prokurorët për trajtimin specifik të fëmijëve të trafikuar, sipas standardeve, PSV-ve dhe udhëzimeve të pranuar.	Policia e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Policisë, Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike, Dhoma Kombëtare e Avokatisë në bashkëpunim me UNICEF, BKTF, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare etj.	Në vazhdimësi	Trajnim i përsëritur specifik për trafikimin e fëmijëve përfshihet në planin e rregullt të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Policisë. Trajnimi i punonjësve të policisë të jetë i detyrueshëm përpara fillimit në një pozicion pune, i cili ka të bëjë me trajtimin e fëmijëve si të dëmtuar apo subjekte të veprës penale.	Ekzistuese
1.(a).6	Ngritja e kapaciteteve të seksioneve të mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje në Policinë e Shtetit, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me aktorë të tjerë, me qëllim evidentimin, koordinimin dhe referimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve pranë strukturave policore kundër trafikëve të paligjshme.	Akademia e Policisë, Seksioni i Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje dhe Sektori kundër Trafikëve të Paligjshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët ndërkombëtarë (OSBE, UNICEF, IOM, UNIFEM, UNDP, UNODC etj.)	Deri në fund të vitit 2011	Seksionet e mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje të kenë trajnimin e duhur për të evidentuar dhe referuar rastet e trafikimit të të miturve pranë strukturave policore përgjegjëse të specializuara.	Ekzistuese
1.(a).6.1	Sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë, bashkërendimi sistematik dhe ndarjeje informacioni midis sektorëve kundër trafikëve të paligjshme dhe seksioneve për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje.	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi	Protokollet e mbledhjeve sistematike që zhvillohen. Numri i çështjeve të filluara nëpërmjet bashkëpunimit me Seksionin e Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje.	Ekzistuese

II. MBROJTJA DHE ASISTENCA PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT FEMIJE

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Sigurimi i identifikimit, referimit, dhënies së mbrojtjes dhe riintegrit të fëmijëve viktimë të trafikimit				
	Synimet/treguesit: rritja e numrit të viktimave fëmijë që janë identifikuar, referuar, kanë marrë mbrojtje dhe janë riintegruar; përmbajtja e protokolleve të rasteve të trajtuara, perceptim i kënaqshëm mbi shërbimet				
1.(a).	OBJEKTIV SPECIFIK: Zbatimi i procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e fëmijëve viktimë të trafikimit				
	Treguesit: numri i fëmijëve të identifikuar dhe referuar; numri i zyrtarëve të trajnuar.				
1.(a).1	Zbatimi i PSV-ve për identifikimin dhe referimin e fëmijëve viktimë të trafikimit	ZKKA, PSH, MPÇSSHB, KKSAT, MPJ, ARSIS, IOM	Mars 2011 Në vazhdimësi	Miratimi i procedurave Trajnimi dhe njohja e standardeve dhe procedurave nga të gjithë aktorët.	Ekzistuese
1(a)2	Monitorimi i zbatimit të PSV-ve me fokus të veçantë fëmijët.	ZKKA, PSH, MPÇSSHB, KKSAT, MPJ, IOM	Në vazhdimësi	Plan monitorimi	Ekzistuese
1(a) 3	Monitorimi i zbatimit të marrëveshjes me Greqinë “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit”	MB/ZKKA, MPJ	Në vazhdimësi	Plan monitorimi Raport mbi zbatimin e Marrëveshjes Numri i fëmijëve	Ekzistuese
1(a) 3.1	Të negociohen marrëveshje dypalëshe për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit.	ZKKA, MPJ	Në vazhdimësi	Marrëveshje dypalëshe me: Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë	Ekzistuese
1.(a).4	Hartimi dhe zbatimi i programeve alternative për integrimin e fëmijëve	MPÇSSHB, KKSAT, ZKKA në bashkëpunim me OJF-të dhe ON-të	2011	Hartimi i programeve. Numri i fëmijëve që përfitojnë prej programeve.	Ekzistuese

III. PARANDALIMI

Nr.	Veprimtaritë dhe nën veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
1.	SYNIMI STRATEGJIK: Përmirësimi i kapaciteteve të personelit të Policisë Kufitare për të identifikuar në kufi fëmijë, viktimë të mundshme të trafikimit, të shoqëruar ose të pashoqëruar, dhe krijimi i një sistemi referimi dhe mbrojtjeje të përshtatshme për këta fëmijë menjëherë pas identifikimit nga personeli kufitar..				
	Treguesit/synimi: Rritja e numrit të fëmijëve të trafikuar të identifikuar dhe ndihmuar.				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi, përmes trajnimeve dhe masave të tjera, i kapacitetit të personelit të policisë kufitare për të identifikuar fëmijë viktimë të mundshme të trafikimit dhe trafikantët e tyre, dhe për të ofruar mbrojtje fillestare të përshtatshme për fëmijën.				
	Tregues: Numri i fëmijëve të identifikuar në kufi; numri i trafikantëve të ndaluar;				
1.(a).1	Përmirësimi, nëpërmjet trajnimeve, i kapacitetit të personelit të policisë kufitare për procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve (PSV) në kuadër të lëvizjes së lirë të personave	Policia e Shtetit/Qendra e Formimit Policor në bashkëpunim me ZKKA dhe shoqërinë civile	Brenda 6-mujorit të parë të 2011 dhe në vazhdimësi	Numri i trajnimeve të organizuara. Numri i pjesëmarrësve në trajnime. Përfshirja e kurrikulës së PSV-ve për identifikimin dhe referimin e vet në trajnimin e specializuar të policisë së kufirit. Trajnimi për identifikimin dhe parandalimin e rasteve të mundshme të trafikimit është pjesë e trajnimit standard për të gjithë personelin e policisë së kufirit.	Ekzistuese
1.(a).2	Sigurimi i pranisë së përhershme të një punonjëseje policie femër (të seksionit kundër trafiqeve të paligjshme dhe policisë kufitare) dhe të një punonjësi social gjatë intervistimit/identifikimit formal, të cilët njohin standardet e trajtimit të fëmijëve dhe PSV-të	Policia e Shtetit, MPÇSSHB/Shërbimi Social Shtetëror, OJF	Brenda 6-mujorit të parë të 2011 dhe në vazhdimësi	Personeli i kontrollit kufitar, i seksioneve kundër trafiqeve të paligjshme, si dhe punonjësit socialë njohin PSV-të dhe standardet. Në të gjitha pikat e kalimit kufitar ka një punonjëse policie femër dhe një punonjës social në gatishmëri për intervistimin dhe asistimin e fëmijëve të identifikuar në kufi	Ekzistuese
1.(a).3	Regjistrimi i të dhënave, të çdo fëmije të shoqëruar apo të pashoqëruar që hyn apo del nga territori i Republikës së Shqipërisë, në pikat e kalimit kufitar dhe në qendër, në përputhje me sistemin TIMS.	Policia e Shtetit/PKM	Në vazhdimësi	Sistemi TIMS funksionon dhe është operativ në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Numri i fëmijëve të regjistruar. Personeli në të gjitha pikat e kalimit kufitar i trajnuar në përdorimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave TIMS.	Ekzistuese
2.	SYNIMI STRATEGJIK: Vazhdimi i forcimit të bashkëpunimit formal dhe <i>ad-hoc</i> në parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe në mbrojtje të fëmijëve viktimë të trafikimit me autoritetet homologe të vendeve fqinje, dhe me struktura kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, ON dhe OJF në këto vende.				
	Synimi/treguesit: numri i çështjeve ndërkuftare, numri i fëmijëve të identifikuar dhe të asistuar; ekzistenca dhe përmbajtja e protokolleve për çështje ndërkuftare; përqindja e të gjithë fëmijëve viktimë të kthyer, të cilëve iu është dhënë ndihmë.				
2.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rishikimi, dhe nëse është e nevojshme, rishikimi i marrëveshjeve dypalëshe ekzistuese me vendet fqinje në lidhje me parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit, dhe negocimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit, aty ku nuk ekzistojnë, sidomos me vendet fqinje dhe vende të tjera të rëndësishme (bazuar në vlerësimin e nevojave); dhe zbatimi i protokolleve teknike për marrëveshjet ekzistuese.				
	Tregues: numri i marrëveshjeve të reja/të ndryshuara që i referohen trafikimit të fëmijëve, ekzistenca e marrëveshjeve dhe/ose protokolleve të reja, ekzistenca e PSV-ve të miratuara ndërkuftare, numri i çështjeve ndërkuftare, koha mesatare e përpunimit.				
2.(a).1	Rishikimi i marrëveshjeve përkatëse dypalëshe policore mes Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, me referencë të veçantë për bashkëpunimin për parandalimin e trafikimit të fëmijëve, dhe përfshirja e dispozitave të posaçme për trafikimin e fëmijëve	MB, Policia e Shtetit, MPJ, MD, MIE	2011-2013	Kryerja e rishikimit; nxjerrje e raportit. Rekomandimet pasqyrohen, marrëveshjet e rishikuara	Ekzistuese
2.(a).2	Nxitja e zbatimit të marrëveshjes ekzistuese me	MB/ZKKA, MPJ, MD	Në vazhdimësi	Dispozita dhe hartimi i PSV-ve për trajtimin e fëmijëve të	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
	Greqinë dhe sigurim i futjes së dispozitave shtesë lidhur me trajtimin e fëmijëve të shoqëruar, viktima të trafikimit.			shoqëruar, viktima të trafikimit.	
2.(a).3	Negocimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me vende kryesore destinacioni, sidomos me vendet fqinje, me fokus bashkëpunimin për: - identifikimin e fëmijëve të trafikuar dhe të shfrytëzuar (të shoqëruar ose të pashoqëruar); - mbledhjen dhe shkëmbimin sistematik të të dhënave për fëmijët e trafikuar, autorët e dyshuar dhe metodat dhe rrugët e përdorura; - bashkërendimin e reagimeve, përfshirë procedurave të rregulluara dhe të miratuara për riatdhesimin në kufi dhe përpunimin e të kthyerve.	MB, Policia e Shtetit, MPJ, MD	2011-2013	Numri i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit të negociuar dhe të nënshkruar me vendet kryesore të destinacionit (bazuar në vlerësimin e nevojave).	Ekzistuese
3.	SYNIMI STRATEGJIK: Përmirësimi i kapaciteteve të agjencive shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse për të identifikuar brenda territorit të vendit fëmijë viktima të mundshme të trafikimit				
	Synimi/treguesit: numri i fëmijëve të identifikuar dhe të asistuar brenda territorit të vendit.				
3. (a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi, përmes trajnimeve dhe masave të tjera, i kapacitetit të agjencive shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse për të identifikuar fëmijë viktima të mundshme të trafikimit për të ofruar mbrojtje fillestare të përshtatshme për fëmijën.				
	Tregues: Numri i fëmijëve të identifikuar brenda territorit të vendit;				
3. (a).1	Përmirësimi, nëpërmjet trajnimeve, i kapaciteteve të sektorit dhe seksioneve kundër trafikëve të paligjshme, prokurorëve për identifikimin e rasteve të viktimave të mundshme fëmijë brenda territorit të vendit.	Policia e Shtetit/Qendra e Formimit Policor, PKR në bashkëpunim me ZKKA dhe shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i trajnimeve të organizuara. Numri i pjesëmarrësve në trajnime	Ekzistuese
3. (a). 2	Përmirësimi, nëpërmjet trajnimeve, i kapaciteteve të punonjësve të Shërbimit Social Shtetëror, stafit mjekësor të institucioneve të shëndetit publik, agjencive të punësimit për identifikimin e rasteve të mundshme të fëmijëve viktima të trafikimit.	MPCSSHB/SHSSH, MSH, në bashkëpunim me ZKKA dhe shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i personave të trajnuar	Ekzistuese
4	SYNIMI STRATEGJIK: Rritja e sensibilizimit të shoqërisë për trafikimin e fëmijëve.				
4.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e sensibilizimit për trafikimin e fëmijëve në publikun e gjerë, strukturat shtetërore dhe joshetërore që punojnë me fëmijë, si dhe grupeve në rrezik në bashkëpunim me mediat, agjencitë shtetërore dhe shoqërinë civile. (shih kapitullin: Parandalimi – strategjia kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore)				
	Tregues: Përqindja e popullsisë që mund të përshkruajë trafikimin e fëmijëve, mund të rendisë qëllimet kryesore përse njerëzit trafikohen, dhe mënyrat kryesore me anë të cilave rekrutohen viktimat; numri i shkollave (sipas niveleve) që përdorin modulet mësimore për çështjet e trafikimit të fëmijëve; përqindja e nxënësve (për lloj niveli arsimor /moshe) që mund të rendisin shkaqet kryesore të trafikimit të fëmijëve dhe mënyrat kryesore të rekrutimit të viktimave.				
4.(a).1	Zhvillimi i fushatave të sensibilizimit që paralajmërojnë rreziqet dhe ndëshkimet që lidhen me trafikimin e fëmijëve, nëpërmjet spoteve dhe programeve në televizion dhe radio, posterave, fletëpalosjeve etj.	MB/ZKKA në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Numri i spoteve televizive dhe radiofonike të transmetuara në mbarë vendin çdo vit. Numri i fushatave të sensibilizimit.	Ekzistuese
4. (a). 1.1	Integrimi i orëve të detyrueshme për trafikimin e personave në programet arsimore të arsimit 9-vjeçar.	ZKKA, MASH/Instituti i Kurrikulës	Brenda 6-mujorit të parë të 2011	Sensibilizimi dhe informacioni rreth trafikimit të fëmijëve i përfshirë në programet mësimore (kurrikula).	Ekzistuese
4. (a).1.2	Organizimi i seminareve për mësuesit/arsimtarët/edukatorët e arsimit bazë, të mesëm, fakulteteve, konvikteve,	ZKKA, MASH, MPCSSHB, shoqëria civile	Çdo vit	Numri i seminareve të organizuara. Numri i pjesëmarrësve në seminare.	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
	institucioneve të përkujdesit për fëmijë, institucioneve të përkujdesit për trafikimin e fëmijëve.				
4.(a).1.3	Zhvillimi i veprimtarive kulturore dhe edukative rreth trafikimit të fëmijëve: organizimi i fushatave të posaçme për parandalim me synim fëmijët në bashkësitë me rrezik të lartë dhe në grupe të tjera në nevojë.	MASH, shoqëria civile	Në vazhdim	Numri i fushatave me synim fëmijët në nevojë të zhvilluara nga OJF-të dhe partnerët me mbikëqyrjen e MASH-it.	Ekzistuese
4.(a).2	Promovimi i mëtejshëm i Kodit të Sjelljes në Turizëm nëpërmjet pasqyrimin në faqet zyrtare të MTKRS dhe ATA, si dhe sensibilizimit të operatorëve të shërbimeve turistike.	MTKRS, Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), ZKKA, OSBE, BKTF	Dy herë në vit	Numri i vizitorëve (operatorëve të shërbimeve turistike) të faqes së ATA dhe MTKRS. Trajnime ndërgjegjësuese të organizuara. Numri i pjesëmarrësve në takimet sensibilizuese .	Ekzistuese
5.	SYNIMI STRATEGJIK: Institucionalizimi mbarëkombëtar i njësive të mbrojtjes së fëmijës, si pjesë e një sistemi të integruar të ndihmës sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, për të identifikuar dhe parandaluar rastet e mundshme të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve.				
	Synimi/treguesit: numri i fëmijëve në rrezik të identifikuar dhe të asistuar; numri i njësive funksionale për mbrojtjen e fëmijëve të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore; ekzistenca dhe numri i sistemeve vendore funksionale të referimit dhe të menaxhimit të rasteve.				
5.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e mbulimit të sistemeve ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve përmes forcimit të NJMF-ve.				
	Tregues: numri i njësive për mbrojtjen e fëmijës (NJMF) me personel të njafatueshëm; numri i fëmijëve në rrezik ose të trafikuar të identifikuar dhe të asistuar.				
5.(a).1	Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve fokusuar kryesisht te fuqizimi i NJMF-ve dhe integrimi i plotë i tyre në komitetet rajonale antitrafik, si dhe në mekanizmin kombëtar të referimit.	MPÇSSH/ Pushteti vendor, shoqëria civile	Brenda 2011	Miratimi i akteve nënligjore në lidhje me komponentët e mekanizmave mbrojtës të ligjit kuadër. NJMF e fuqizuara.	Ekzistuese
5.(b)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e personelit minimal të njësive të mbrojtjes së fëmijës në dy punonjës me kohë të plotë nga pushteti vendor.				
	Tregues: Numri i personelit me kohë të plotë për çdo njësi të mbrojtjes së fëmijëve.				
5.(b).1	Rritja e personelit të NJMF-ve	MPÇSSHB, njësitë e pushtetit vendor	Brenda 2011	Personi i NJMF-së shtuar me të paktën 2 punonjës (në bashkitë e mëdha).	Ekzistuese
5.(c)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Integrimi i punës së NJMF-ve me punën e pikave të kontaktit për dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, barazinë gjinore në nivel bashkie dhe komune dhe institucionalizimi i raportimit të integruar rreth çështjeve në lidhje me fëmijët dhe mbrojtjen sociale në nivel qendror dhe vendor.				
	Treguesit: Ekzistenca e grupeve multidisiplinore për identifikimin, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës.				
5.(c).1	Qartësim i rolit të strukturave identifikuese, referuese dhe mbrojtëse në nivel bashkie/komune si pjesë e MKR-së; vendosja e mekanizmave të qartë bashkërendues, bashkëpunues dhe raportues në nivel qendror dhe vendor.	MPÇSSHB, nënshkruarit e MKR, ZKKA, KRAT, partnerët lokalë (shtetërorë dhe joshetërorë).	Brenda 6-mujorit të parë të 2011	Ekzistenca e planeve të sistemeve vendore të referimit dhe menaxhimit të rasteve që detajojnë rolin e zyrave të asistencës dhe mbrojtjes sociale dhe rolin e tyre në MKR.	Ekzistuese
5.(c).1.1	Rritja e kapaciteteve të strukturave në nivel bashkie/komune.	Pushteti vendor	Në vazhdim	Numri i trajnimeve	Ekzistuese
5.(c).2	Institucionalizimi i raportimit të integruar dhe adresimit/menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë në nivel qendror dhe vendor për çështje të trafikimit të fëmijëve.	MPÇSSHB/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës	Në vazhdim	Protokolle për raportimin e informacionit të integruar dhe funksionimin e strukturave për mbrojtjen dhe asistencën sociale të zhvilluara dhe të miratuara me tryeza teknike rajonale dhe sekretariate. Takime periodike për adresimin e rasteve me tryeza teknike dhe grupe shumëdisiplinore të institucionalizuara.	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
5.(d)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i sistemeve efektive dhe të institucionalizuara për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, me qëllim identifikimin e grupeve dhe individëve në rrezik, si dhe të miturve të trafikuar, dhe sigurimi i masave të synuara parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese.				
	Tregues: Numri i fëmijëve në rrezik dhe të trafikuar të identifikuar dhe të asistuar.				
5.(d).1	Ngritja dhe funksionimi i grupeve ndërdisiplinore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në nivel bashkie/komune, përbërë nga: - punonjës të NJMF, psikologu në shkollë, administratorët e shërbimeve shoqërore, mjeku i familjes, punonjësi social i qendrave rezidenciale apo ditore për fëmijë etj., si dhe - trajnimi i tyre për zbatimin e PSV-ve për identifikimin dhe referimin e fëmijëve të trafikuar ose në rrezik trafikimi.	Pushteti vendor, ZKKA me partnerët lokalë shtetëror dhe joshetërorë	Brenda vitit 2011 Në vazhdim Në vazhdim	Protokolle dhe marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të formalizuara. PSV për identifikim dhe referim të miratuara. Të gjithë aktorët përkatës të trajnuar për PSV-të. Takime periodike me grupe shumë-disiplinore të institucionalizuara.	Ekzistuese
6.	SYNIMI STRATEGJIK: Rritja e përfshirjes sociale për fëmijët dhe të rinjtë, duke nxitur arsimimin dhe përfitim të aftësive jetësore, krahas zhvillimit të komunitetit				
	Synimet/treguesit: reduktimi i mëtejshëm i përqindjes së braktisjes së shkollës; rritja e nivelit arsimor/formimit profesional/jetesës për të rinjtë dhe të rejtat.				
6.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ndërmarrja e masave shtetërore për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët dhe hartimi i procedurave për integrimin akademik dhe/ose formimin profesional të fëmijëve nën kujdestari, si edhe fëmijëve që nuk frekuentojnë shkollën dhe rrezikohen më shumë për t'u trafikuar.				
	Treguesit/synimet: rritja e përqindjes së frekuentimit të shkollës dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në shkollë, si edhe në veçanti identifikimi i grupeve në rrezik.				
6.(a).1	Rritja e ndërgjegjësimin publik në lidhje me arsimin e detyruar.	MASH, ZKKA, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të arsimit, KRAT, BKTF, NJMF, shoqëria civile	Në vazhdim	Numri i fushatave ndërgjegjësuere. Përqindja e publikut dhe grupeve në rrezik që janë ndërgjegjësuar lidhur me arsimin e detyruar.	Ekzistuese
6.(a).2	Udhëzimi i strukturave shtetërore të arsimit në nivel vendor për identifikimin e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin e detyruar.	MASH	Brenda 2011	Ekzistenca e udhëzimeve	Ekzistuese
6.(a).3	Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet zyrave të gjendjes civile dhe shkollave për çdo fëmijë, i cili ka mbushur moshën për të hyrë në shkollë.	MASH, MB/DPGJC	Brenda 6-mujorit të parë të 2011	Nënshkrimi i marrëveshjes së përbashkët ndërmjet MASH dhe MB/DPGJC. Numri i fëmijëve të regjistruar.	Ekzistuese
6.(a).4	Organizimi i veprimtarive të posaçme edukative për fëmijët në nevojë, dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, bazuar në vlerësimin e nevojave.	MASH, ZKKA, MPÇSSHB, në bashkëpunim me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Hartimi i planeve vjetore konkrete të punës. Numri i veprimtarive edukative për këto grupe; numri i pjesëmarrësve.	Ekzistuese
6.(a).5	Organizimi i orëve të integruara të mësimin, me programe arsimore të posaçme për fëmijët që kanë braktisur apo nuk shkojnë në shkollë, duke u përqendruar veçanërisht te fëmijët e bashkësisë rome dhe "fëmijët në situatë rruge". Hartimi i programe alternative arsimore brenda sistemit të shkollës (klasa mbështetëse ose programe të përshpejtuara) për këtë kategori fëmijësh.	MASH, ZKKA, MPÇSSHB, në bashkëpunim me BKTF dhe shoqërinë civile	Brenda 2011	Ekzistenca e programeve të posaçme/ alternative për fëmijët që braktisin shkollën në të gjithë vendin. Numri dhe përqindja e atyre që braktisin shkollën (meshkuj/femra), të cilët marrin pjesë në këto programe.	Ekzistuese
6.(a).6	Sigurimi i monitorimit të punës së paligjshme të fëmijëve nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe marrja e masave për parandalimin dhe/ose eliminimin e punës së fëmijëve.	MPÇSSHB/Inspektorati i Përgjithshëm i Punës	Në vazhdimësi	Përqindja e ndërmarrjeve të kontrolluara nga Inspektorati i Punës (në vit). Raportimi mes rasteve të adresuara në	Ekzistuese

Nr.	Veprimtaritë dhe nën veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim)	Afatet	Treguesit/synimet	Burimet
				krahasim/përpjesëtim me rastet e zbuluara. Numri i rasteve të zbuluara.	
6.(a).7	Marrja e masave për përmirësimin e situatës ekonomike të fëmijëve dhe familjeve të tyre në nevojë (përfshi programe punësimi, skema mikrokredie, ofrimi i ndihmës materiale, financiare e të tjera). Ndërtimi i një baze të dhënash (regjistri) për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre në nivel qendror dhe vendor.	MPÇSSHB, KRAT, pushteti vendor së bashku me shoqërinë civile	Në vazhdimësi	Ndihma/mbështetja ofruar familjeve të identifikuara në nevojë. Synimi: rritja e të ardhurave të familjeve/grupeve në nevojë .	Ekzistuese

VENDIM
Nr.8, datë 16.3.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pilloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 26.10.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 23/8 Akti që i përket:

KËRKUESE: Zhaneta Melonashi, përfaqësuar nga avokatët Sotiraq Ceta dhe Skënder Kaçupi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.212, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.110, datë 9.10.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë, nr.00-2009-152 (447), datë 25.9.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 42, 131/f, 134, pika 1/g dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e kërkuases që u shprehën për pranimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.212, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e pandehura Zhaneta Melonashi (kërkuesja) është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale "Mjekim i pakujdesshëm", parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal (KP), dhe është dënuar me 1 500 000 lekë gjobë.

Me vendimin nr.110, datë 9.10.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë ka ushtruar rekurs kërkuesja Zhaneta Melonashi.

Me vendimin nr.00-2009-152 (447), datë 25.9.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se ai nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Kërkuesja Zhaneta Melonashi, me kërkesën e datës 22.4.2010, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme të gjykatave, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi nëpërmjet shprehjeve paragjyqese kanë shpallur fajësinë e kërkueses që në fillim të gjykimit dhe para dhënies së vendimit.

- Vendimet e gjykatave të tri shkallëve të gjykimit janë të paarsyetura dhe të paargumentuara.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e ligjshmërisë, të barazisë së armëve, të mbrojtjes, efektive si dhe të drejtën që i pandehuri të dëgjohet para se të gjykohet. Duke u vendosur mospranimi i rekursit për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi, nuk janë trajtuar shkaqet e ngritura në rekurs. Mosnënshkrimi i rekursit (gabimisht) nga mbrojtësi nuk duhej të sillte automatikisht mospranimin e rekursit, pasi ky fakt nuk mund të mohojë të drejtën e të pandehurit të bëjë vetë rekurs para gjykatës.

Subjekti i interesuar, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në parashtrimet drejtuar me shkrim Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të përmbledhur argumenton:

- Në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, në kërkesë nuk rezulton asnjë referim konkret në shprehje paragjyqese të pretenduara si të përdorura nga gjykatat, në raste të mohimit të pyetjes së dëshmitarëve, marrjes së provave të reja ose në pretendime të paraqitura dhe të mbetura pa shqyrtuar nga gjykatat.

- Në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me themelin e çështjes, ato nuk mund të jenë objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese, pasi vlerësimi i gjendjes së fakteve, i pretenduar nga palët në gjykim, është kompetencë ekskluzive e gjykatave të faktit.

- Kërkesa për nënshkrimin e aktit të rekursit nga mbrojtësi është kërkesë ligjore e përcaktuar shprehimisht në nenin 435/2 të KPP-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se e drejta e të pandehurit për t'u ankuar në Gjykatën e Lartë nuk cenohet për shkak të vendosjes së këtij detyrimi ligjor, pasi në çdo rast i pandehuri ka të gjitha mundësitë për të gjetur mbrojtës, madje edhe kur është në pamundësi financiare. Kërkuesja nuk rezulton të ketë parashtruar pretendime për kushtetutshmërinë e vetë nenit 435/2 të KPP-së dhe, për sa kohë kjo dispozitë nuk është objekt gjykimi, duhet të prezumohet se ajo është në përputhje me Kushtetutën, sido që mund të jenë opinionet rreth formulimit të saj aktual.

II

1. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

Kërkuesja pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi nëpërmjet shprehjeve paragjyqese kanë shpallur fajësinë e saj që në fillim të gjykimit, para dhënies së vendimit.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor dhe garantohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit: *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”*. Sipas këtij parimi, gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet; barra e provës i takon palës akuzuese; çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.9.2008; nr.16, datë 15.6.2009; nr.23, datë 23.7.2009*).

Bazuar në sa më sipër Gjykata vlerëson nëse gjatë procesit është shkelur ndonjë nga elementet e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Nga vlerësimi në tërësi i materialeve, paraqitur Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton ndonjë e dhënë, e cila të tregojë se gjyqtarët e gjykatave, që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesja e ka kryer veprën penale. Në to nuk përmbahet ndonjë deklaram formal ose arsyetim, i cili të tregojë se gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Korçë e kanë konsideruar fajtores kërkuesen para se të jepej vendimi përfundimtar për fajësinë e saj. Gjykatat e zakonshme nuk e kanë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek e pandehura.

Për sa më sipër, pretendimi i kërkueses për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

2. Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve të gjykatave

Kërkuesja pretendon se vendimet e gjykatave janë të paarsyetuara dhe janë marrë në kundërshtim të hapur me provat dhe duke bërë vlerësim të gabuar të tyre.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor (detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës) si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.4.2008; nr.7, datë 9.3.2009; nr.23, datë 23.7.2009; nr.38, datë 30.12.2010*).

Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që vendimet e gjykatave të jenë të paarsyetuara, në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës dhe të KPP-së. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë analizuar dhe shqyrtuar të gjitha rrethanat e çështjes, provat e paraqitura, elementet e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesja, i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses dhe kanë parashtruar në vendim të gjitha argumentet për deklaramin e saj fajtores. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar këto prova nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese, sepse kjo Gjykatë mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Në sferën e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet mënyra e zbatimit të ligjit material dhe e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 17.5.2010*).

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkueses është i pabazuar.

3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës për t`iu drejtuar Gjykatës së Lartë

Kërkuesja pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, i ka cenuar të drejtën për t`iu drejtuar asaj gjykate dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në rekurs. Sipas kërkueses, mosnënshkrimi i rekursit nga mbrojtësi nuk duhet të sillte automatikisht mospranimin e rekursit, pasi ky fakt nuk mund të mohojë të drejtën e të pandehurit të bëjë vetë rekurs para gjykatës.

Gjykata është shprehur, në jurisprudencën e saj, se e drejta për një proces të rregullt ligjor, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, ka si element përbërës, midis të tjerash, edhe të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009; nr.38, datë 30.12.2010*).

Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e së drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore, me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010; nr.38, datë 30.12.2010*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009; nr.38, datë 30.12.2010*).

Në vijim të garancive të ofruara nga neni 42 i saj, Kushtetuta parashikon në nenin 43 se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 5.7.2005; nr.5, datë 6.03.2009*).

Për këtë qëllim dispozitat procedurale parashikojnë si mjete ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe kërkesën për rishikim (neni 407 i KPP-së), duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit. Në nenin 410/1 të KPP-së parashikohet se i pandehuri mund të bëjë ankim personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Në lidhje me rekursin në Gjykatën e Lartë, neni 435/2 i KPP-së parashikon se "*Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësi*". Neni 420 i KPP-së parashikon se ankimi nuk pranohet, midis të tjerave, kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesja Zhaneta Melonashi ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs, i cili ka qenë i panënshkruar nga mbrojtësi i saj dhe për këtë arsye, bazuar në nenin 435/2 të KPP-së, Kolegji Penal, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e tij.

Në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Gjykata rithekson se neni 435/2 i KPP-së interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë (*stricto sensu*), që cenon thelbin e të drejtës së një individit për t'iu drejtuar asaj gjykate. Zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme të këtij Kodi që disjolinonë paraqitjen e ankimit (nenet 407-421), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së, ai nuk mund të privohet nga e drejta që pretendimet e ngritura në rekurs të vlerësohen sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 30.12.2010*).

Gjykata çmon se çdo interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Referimi i bërë nga Kolegji Penal vetëm në kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat e nenit 432 të KPP-së për shqyrtimin e rekursit, cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor lidhur me vënien në dijeni të rekursuesit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin e mbrojtësit, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë

dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se “*sekretaritë e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i pa nënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP-së, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij*”.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të panënshkruar nga mbrojtësi, ka cenuar të drejtën e kërkueses për t`iu drejtuar kësaj gjykate.

Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, kërkueses Zhaneta Melonashi i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2009-152 (447), datë 25.9.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në këtë gjykatë.

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.212, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të vendimit nr.110, datë 9.10.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Petrit Ploçi, Sokol Sadushi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbraja ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 29.3.2011
Doli nga shtypi më 31.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë